

**HYRJE**

**E nderuar znj. Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë**

**Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë**

“Raporti Vjetor mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri gjatë vitit 2012” është një material i sintetizuar mbi aktivitetin profesional të organit të Prokurorisë gjatë vitit të kaluar.

Konstatohet se gjatë vitit 2012 është shënuar një volum pune në rritje, si përsa u përket fillimit të hetimeve, ashtu edhe regjistrimit të procedimeve dhe ndjekjes penale në nivel kombëtar. Krahasuar me vitin 2011, rritje të ndjeshme konstatohet në volumin e punës në Prokuroritë e Apeleve dhe në Prokurorinë e Përgjithshme.

Në raport paraqiten të detajuara statistika mbi situatën e kriminalitetit në vend, si edhe angazhimin e strukturave të prokurorisë në bashkëpunim me organet e tjera ligjzbatuese, ku volumin kryesor e përbën koordinimi me Policinë e Shtetit, me Shërbimin Informativ Shtetëror, si edhe institucione të tjera që janë të ngarkuara me ligj për të evidentuar dhe referuar shkelje të ligjit penal.

Aktiviteti i organit të Prokurorisë është dinamik, i cili kërkon shpejtësi reagimi dhe zbatim rigoroz të ligjit. Krahas punës voluminoze gjatë vitit 2013, fokusi kryesor do të jenë krimet e rënda me dashje, gjakmarrja, krimi në familje dhe korrupsioni, vepra penale, të cilat kanë impaktin më të fortë në opinionin publik.

Ndër prioritetet e vitit në vijim, të prezantuara në “Raport...”, janë rritja e efikasitetit të institucionit të prokurorisë, nëpërmjet ashpërsimit të politikës penale, si edhe forcimi i kontrollit periodik në prokuroritë e të gjitha niveleve.

Gjithashtu, në përbushje të detyrimeve ndërkombëtare të Shqipërisë, organi i prokurorisë do të vijojë të jetë bashkëpunues me organet homologe dhe agjencitë dhe përfaqësitë e huaja diplomatike në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar dhe trafikeve të paligjshme.

## **VOLUMI I PUNËS I ORGANIT TË PROKURORISË PËR VITIN 2012**


Prokurorët janë të organizuar dhe funksionojnë pranë sistemit gjyqësor si një organ i centralizuar. Funkzioni i prokurorit duhet të ushtrohet në mënyrë të paanshme dhe objektive. Në ushtrimin e kompetencave të tyre prokurorët u nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve. Prokuroria si organ i pavarur punën e saj e bazon në parimin e pavarësisë kundrejt të gjithë pjesëmarrësve në procesin penal si dhe organeve të tjera shtetërore.

Organet e prokurorisë janë:

- a) Prokuroria e Përgjithshme;
- b) Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda;
- c) Prokuroritë pranë gjykatave të Apelit;
- d) Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda;
- e) Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë.

Gjatë vitit 2012, në organin e prokurorisë janë trajtuar **36492** procedime për vepra penale të ndodhura (ku përfshihen procedimet penale të regjistruara si dhe kallëzimet penale të depozituara në organin e prokurorisë). Nga këto, janë ndjekur **27626** procedime penale (rritje prej 10,61% (për qind) në krahasim me vitin 2011; prej të cilave janë regjistruar **22079** procedime penale (rritje prej 11,91% (për qind) në krahasim me vitin 2011; janë mbartur nga viti i kaluar **4999** procedime (rritje prej 6,67% (për qind) në krahasim me vitin 2011 dhe janë rifilluar **548** procedime (ulje prej 2,66% (për qind) në krahasim me vitin 2010. Është vendosur mosfillimi për **8866** procedime, që do të thotë rritje prej 13,76% (për qind) në krahasim me vitin 2010.

## **VOLUMI I PUNËS NË HETIM PËR VITIN 2012**




Gjatë vitit 2012 nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë është ngritur dhe përfaqësuar akuza në gjykatë në emër të shtetit shqiptar për 7298 procedime (ulje prej 1,69% në krahasim me vitin 2011) me 9354 të pandehur, përkundrejt 9256 të pandehur në vitin 2011 (rritje prej 1,05% në krahasim me vitin 2011). Gjithashtu, janë paraqitur në gjykatë 10676 kërkesa për caktimin e masave të sigurimit personal (rritje prej 7,23% në krahasim me vitin 2011).

Nga prokuroritë pranë gjykatave të apelit është përfaqësuar akuza në emër të shtetit shqiptar për 3521 çështje themeli (rritje prej 12,06% në krahasim me vitin 2011) dhe 1765 raste për masat e sigurimit personal (rritje prej 5,12% në krahasim me vitin 2011).


Prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme kanë përfaqësuar akuzën në emër të shtetit shqiptar pranë Gjykatës së Lartë për gjykime themeli, masa sigurimi personal, përfaqësime në Kolegjet e Bashkuara dhe në cilësinë e subjektit të interesuar në mbrojtje të interesave të shtetit dhe të individëve pranë Gjykatës Kushtetuese për 433 çështje (rritje prej 32,41% në krahasim me vitin 2011).

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:


**VOLUMI I PUNËS I ORGANIT TË PROKURORISË PËR  
ÇËSHTJE TË PËRFAQËSUARA NË GJYQ NË VITIN  
2012**



Më poshtë paraqitet në mënyrë grafike volume I punës I organit të prokurorisë për vitet 2011-2012:



Më poshtë paraqitet në mënyrë grafike volumi i punës i organit të prokurorisë për procedimet penale të regjistruara në pesë vitet e fundit:




Rezultoni nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 janë regjistruar 16910 procedime penale, që do të thotë ulje prej 2,54% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 janë regjistruar 19286 procedime penale, që do të thotë rritje prej 14,05% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në vitin 2011 janë regjistruar 19726 procedime penale që do të thotë rritje prej 2,28% (për qind) në krahasim me vitin 2010 dhe në vitin 2012 janë regjistruar 22079 procedime penale që do të thotë rritje prej 11,92% në krahasim me vitin 2011.

Me rritje rezultojnë të jetë edhe volumi i punës së organit të prokurorisë në lidhje me procedimet penale që kanë qenë në ndjekje penale gjatë vitit 2012.

Sikurse vihet re edhe nga grafiku, procedimet në ndjekje penale nga organi i prokurorisë kanë ardhur gjithnjë në rritje: kështu, në vitin 2008 kanë qenë 21278 procedime në ndjekje penale, që do të thotë rritje prej 20,14% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 janë 22276 procedime në ndjekje penale, që do të thotë rritje prej 4,69% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 janë 24506 procedime në ndjekje penale, që do të thotë rritje prej 10% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në vitin 2011 janë 24975 procedime penale në ndjekje penale, që do të thotë rritje prej 1,92% (për qind) në krahasim me vitin 2010 dhe në vitin 2012 janë në ndjekje penale 27626 procedime në ndjekje penale që do të thotë rritje prej 10,61% (për qind) në krahasim me vitin 2011.

**NE NDJEKJE PENALE 2007-2012**



Në lidhje me çështjet e përfunduara, në vitin 2008 ka rritje prej 3,39% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka rritje prej 7% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 ka rritje prej 9,34% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në vitin 2011 ka përsëri rritje prej 2,28% (për qind) në krahasim me vitin 2010 dhe në vitin 2012 ka rritje prej 10,06% (për qind) në krahasim me vitin 2011.


Në lidhje me çështjet e pushuara, në vitin 2008 ka ulje prej 12,53% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka rritje prej 9,8% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 ka rritje prej 4,37% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në vitin 2011 ka ulje prej 12,6% (për qind) në krahasim me vitin 2010 dhe në vitin 2012 ka rritje prej 29,63% (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Në lidhje me çështjet e pezulluara, në vitin 2008 ka rritje prej 7,66% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 rritje prej 27% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 ka rritje prej 15,11% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në vitin 2011 ka përsëri rritje prej 15,87% (për qind) në krahasim me vitin 2010 dhe në vitin 2012 ka rritje prej 10,63% (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Në lidhje me çështjet e dërguara në gjyq, në vitin 2008 ka rritje prej 7,68% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka ulje prej 5,84% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 ka rritje prej 10,78% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në vitin 2011 ka rritje prej 119% (për qind) në krahasim me vitin 2010 dhe në vitin 2012 ka ulje prej 1,69% (për qind) në krahasim me vitin 2011.


Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

**PROCEDIME TE PERFUNDUARA**



Më poshtë paraqiten të dhëna në lidhje me të pandehurit sipas mënyrës së përfundimit të ndjekjes penale në hetimet paraprake:

**TË PANDEHUR TË PËRFUNDUAR 2008-2012**




Sikurse vihet re nga tabela, rezulton se numri të pandehurve të dërguar në gjyq në vitin 2008 ka rritje prej 13,04% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka ulje të pandehurve të dërguar në gjyq prej 4,28% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 ka rritje prej 10,88% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në vitin 2011 janë dërguar në gjyq 9256 të pandehur, përkundrajt vitit 2010 kur janë dërguar gjyqit 9261 të pandehur dhe në vitin 2012 ka rritje prej 1,05% (për qind) të numrit të të pandehurve të dërguar në gjyq në krahasim me vitin 2011.

Vendi që zënë vendimet e gjykatës për pushimin e çështjeve, përkundrajt numrit total të çështjeve të dërguara në gjyq, rezulton të jetë si më poshtë:

Në vitin 2009 vendimet e gjykatës për pushimin e çështjes zënë 2,9% (për qind) në numrin e përgjithshëm të çështjeve të dërguara gjyqit; në vitin 2010 është 3,42% (për qind); në vitin 2011 vendi që zënë vendimet e gjykatës për pushimin e çështjeve në numrin e përgjithshëm të çështjeve të dërguara gjyqit, është 3,11% (për qind) dhe në vitin 2012 kyb tregues është 14,49% (për qind).

Në lidhje me pushimin e akuzës për të pandehurit, dinamika në pesë vitet e fundit është e tillë që: në vitin 2008 ka ulje prej 20,66% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka rritje prej 3,77% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 ka rritje prej 36,73% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në vitin 2011 ka ulje të lehtë prej 1,37% (për qind) në krahasim me vitin 2010 dhe në vitin 2012 ka rritje prej 10,89% (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Më poshtë paraqiten të dhëna në lidhje me të pandehurit për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë nga ana e organit të prokurorisë dhe vendimet e gjykatës në lidhje me pafajësinë në pesë vite, 2008-2012:



Në lidhje me vendimet e gjykatës për pafajësinë, rezultojnë nga të dhënat statistikore se: në vitin 2008 ka rritje prej 6,28% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka rritje prej 29,56% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 ka ulje prej 0,41% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në vitin 2011 ka ulje prej 2,5% (për qind) në krahasim me vitin 2011 dhe në vitin 2012 ka ulje prej 5,55% (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Nga të dhënat statistikore rezultojnë se: në vitin 2007 nga totali i të pandehurve të dërguar në gjyq, vetëm 2,26% (për qind) kanë marrë pafajësi me vendim gjykate; në vitin 2008, nga totali i të pandehurve të dërguar në gjyq, vetëm 2,13% (për qind) kanë marrë pafajësi me vendim gjykate; në vitin 2009, nga totali i të pandehurve të dërguar në gjyq, vetëm 2,88% (për qind) kanë marrë pafajësi me vendim gjykate dhe në vitin 2010, nga totali i të pandehurve të dërguar në gjyq, vetëm 2,59% (për qind) kanë marrë pafajësi me vendim gjykate; në vitin 2011, nga totali i të pandehurve të dërguar në gjyq, vetëm 2,52% (për qind) kanë marrë pafajësi me vendim gjykate dhe në vitin 2012, nga totali i të pandehurve të dërguar në gjyq vetëm 2,36% (për qind) kanë marrë pafajësi me vendim gjykate.

### PEZULLIMET


Mbështetur në parashikimet e Kodit të Procedurës Penale, prokurori është organi kompetent për të vendosur pezullimin e hetimeve kur nuk njihet autori i veprës penale ose kur i pandehuri vuan



nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm. Pezullimi i hetimeve vendoset pasi të jenë kryer të gjitha veprimet e mundshme dhe hetimi i pezulluar mund të rifillojë me vendimin e prokurorit.

Ky tregues në vitet 2007-2012, rezulton nga të dhënat statistikore si më poshtë:


**PROCEDIME TË PEZULLUARA 2007-2012**



Në lidhje me pezullimet rezulton nga të dhënat statistikore se: në vitin 2008 ka rritje prej 7,66% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka rritje prej 27,02% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 ka rritje prej 15,11% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në vitin 2011 ka rritje prej 15,87% (për qind) në krahasim me vitin 2010 dhe në vitin 2012 ka rritje prej 10,63% të vendimeve të prokurorit për pezullimin e hetimeve.

për vitin 2012, procedimet penale të pezulluara për moszbulim të autorit sipas veprave penale paraqiten grafikisht si më poshtë (për efekt të paraqitjes grafike nuk janë perfshirë në grafik procedime penale të pezulluara, për vepra të ndryshme penale, numri i të cilave është nën shifrën 15 procedime):

**PROCEDIME TE PEZULLUARA SIPAS VEPRAVE PENALE  
2012**




**MOSFILLIMET**

Organi i prokurorisë është organi kompetent që bën regjistrimin e njoftimit të veprave penale të cilat mund të vijnë nga subjekte e në rrugë të ndryshme. Kjo nuk do të thotë se në çdo kallëzim të bërë nga subjektet e parashikuara nga nenet 281 dhe vijues të Kodit të Procedurës Penale ekzistojnë elementët e veprave penale. Me qëllim që të evitohen hetimet e panevojshme, ligjvënësi në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale ka parashikuar edhe të drejtën e prokurorit që në mungesë të ekzistencës së rrethanave për fillimin e procedimit, të japë vendimin e arsyetuar për mosfillimin e procedimit.

Ky tregues i punës, i parë edhe si mjet për të evituar hetimet e panevojshme për kallëzimet ku mungon baza ligjore, ka pësuar një rritje këtë vit në krahasim me vitin e kaluar. Kështu, ndërsa në vitin 2011 është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 7793 kallëzime, në vitin 2012 janë marrë 8866 vendime të tilla.

**PROCEDIME MOSFILLUAR**



Në lidhje me procedimet për të cilat është vendosur mosfillimi, rezulton nga të dhënat statistikore se:

në vitin 2007 ka rritje prej 19,04% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka rritje prej 13,64% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka rritje prej 22,63% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 ka rritje prej 23,54% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në vitin 2011 ka rritje prej 11,07% (për qind) në krahasim me vitin 2010 dhe në vitin 2012 ka rritje prej 13,76% në krahasim me vitin 2011.


**PROCEDIME PENALE TË REGJISTRUARA SIPAS PROKURORIVE TË RRETHEVE GJYQËSORE**

Në prokurorinë e rrethit gjyqësor Durrës janë regjistruar 1983 procedime penale, që do të thotë rritje prej 13,96% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Elbasan janë regjistruar 1771 procedime penale, që do të thotë rritje prej 17,90% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Fier janë regjistruar 1295 procedime penale, që do të thotë rritje prej 45,01% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Gjirokastrë janë regjistruar 689 procedime penale, që do të thotë rritje prej 20,03% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Kavajë janë regjistruar 375 procedime penale, që do të thotë rritje prej 2,73% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Krujë janë regjistruar 538 procedime penale, që do të thotë rritje prej 26,88% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Kukës janë regjistruar 384 procedime penale, që do të thotë rritje prej 12,6% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Kurbin janë regjistruar 334 procedime penale, që do të thotë rritje prej 20,14% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Lezhë janë regjistruar 744 procedime penale, që do të thotë rritje prej 6,89% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Lushnje janë regjistruar 465 procedime penale, që do të thotë rritje prej 2,64% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Përmet janë regjistruar 110 procedime penale, që do të thotë rritje prej 17,02% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Pukë janë regjistruar 148 procedime penale, që do të thotë rritje prej 12,12% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë janë regjistruar 5958 procedime penale, që do të thotë rritje prej 16,23% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Tropojë janë regjistruar 193 procedime penale, që do të thotë rritje prej 44,02% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Vlorë janë regjistruar 1880 procedime penale, që do të thotë rritje prej 26,25% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë për Krime të Rënda janë regjistruar 208 procedime penale, që do të thotë rritje prej 92,59% (për qind) në krahasim me vitin 2011;


në prokurorinë e rrethit gjyqësor Berat janë regjistruar 838 procedime penale, që do të thotë ulje prej 5,73% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Dibër janë regjistruar 379 procedime penale, që do të thotë ulje prej 6,87% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Korçë janë regjistruar 1188 procedime penale, që do të thotë ulje prej 8,19% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Mat janë regjistruar 262 procedime penale, që do të thotë ulje prej 0,38% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Pogradec janë regjistruar 405 procedime penale, që do të thotë ulje prej 10,59% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Sarandë janë regjistruar 537 procedime penale, që do të thotë ulje prej 10,5% (për qind) në krahasim me vitin 2011 dhe në prokurorinë e rrethit gjyqësor Shkodër janë regjistruar 1360 procedime penale, që do të thotë ulje prej 4,82% (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:





Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në përqindje mbi procedimet penale të regjistruara sipas prokurorive të rretheve gjyqësore në vitin 2012:




### KOEFICIENTËT E KRIMINALITETIT PËR 100.000 BANORË

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000<sup>1</sup> banorë në vitin 2012 është 784 ndërsa në vitin 2011 ishte 695.12.

Në lidhje me koeficientët e kriminalitetit për 100.000 banorë, rezulton nga të dhënat statistikore se:


<sup>1</sup> Llogaritja e koeficientit të kriminalitetit është bërë mbi shkresën e INSTATnr. 68/1 prot. Datë 23.01.2013 ku jepen të dhënat mbi popullsinë së llogaritur më 1 janar 2012 sipas qarqeve

në prefekturën Berat që përfshin prokurorinë e rrethit gjyqësor Berat koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2012 është 590; në prefekturën Dibër që përfshin prokuroritë e rretheve gjyqësore Dibër dhe Mat, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2011 është 468; në prefekturën Durrës që përfshin prokuroritë e rretheve gjyqësore Durrës dhe Krujë, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2011 është 950; në prefekturën Elbasan që përfshin prokurorinë e rrethit gjyqësor Elbasan koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2011 është 597; në prefekturën Fier që përfshin prokuroritë e rretheve gjyqësore Fier dhe Lushnje koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2011 është 566; në prefekturën Gjirokastrë që përfshin prokuroritë e rretheve gjyqësore Gjirokastrë dhe Përmet koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2011 është 1110; në prefekturën Korçë që përfshin prokuroritë e rretheve gjyqësore Korçë dhe Pogradec koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2011 është 721; në prefekturën Kukës që përfshin prokuroritë e rretheve gjyqësore Kukës dhe Tropojë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2011 është 676; në prefekturën Lezhë që përfshin prokuroritë e rretheve gjyqësore Lezhë dhe Kurbin koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2011 është 801; në prefekturën Shkodër që përfshin prokuroritë e rretheve gjyqësore Shkodër dhe Pukë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2011 është 698; në prefekturën Tiranë që përfshin prokuroritë e rretheve gjyqësore Tiranë dhe Kavajë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2011 është 829 dhe në prefekturën Vlorë që përfshin prokuroritë e rretheve gjyqësore Vlorë dhe Sarandë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2011 është 1367.





**KRIMINALITETI SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL**






Rezulton nga të dhënat statistikore se:

1. Pesha specifike që zënë veprat penale **“Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit”** për të cilat janë regjistruar 245 procedime penale në vitin 2012, është 1.1%;
2. Pesha specifike që zënë **“Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes”** për të cilat janë regjistruar 371 procedime penale në vitin 2012 është 1,68%;
3. Pesha specifike që zënë **“Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit”** për të cilat janë regjistruar 427 procedime penale në vitin 2012 është 1.93% (për qind);
4. Pesha specifike që zënë **“Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik”** për të cilat janë regjistruar 482 procedime penale në vitin 2012, është 2,18% (për qind);
5. Pesha specifike që zënë **“Mastrimet”**, për të cilat janë regjistruar 567 procedime penale në vitin 2012, është 2,56% (për qind);
6. Pesha specifike që zënë **“Krime kundër jetës të kryera me dashje”** për të cilat janë regjistruar 679 procedime penale në vitin 2012, është 3.07% (për qind);
7. Pesha specifike që zënë veprat penale që lidhen me **“Shkatërrimi i pronës”**, për të cilat janë regjistruar 1013 procedime penale në vitin 2012, është 4.58% (për qind);
8. Pesha specifike që zënë **“Veprat penale të kryera me dashje kundër shëndetit”**, për të cilat janë regjistruar 1153 procedime penale në vitin 2012, është 5.22% (për qind);
9. Pesha specifike që zënë **“Falsifikimi i dokumenteve”** për të cilat janë regjistruar 1228 procedime penale në vitin 2012, është 5.56% (për qind);
10. Pesha specifike që zënë **“Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike”**, për të cilat janë regjistruar 4331 procedime penale në vitin 2012, është 19.61% (për qind);
11. Pesha specifike që zënë veprat penale në lidhje me **“Vjedhja e pasurisë”**, për të cilat janë regjistruar 9623 procedime penale në vitin 2012, është 43.58% (për qind);


Më poshtë paraqitet në mënyrë grafike procedimet penale të regjistruara, në vlerë absolute, sipas strukturës së Kodit Penal për vitet 2011-2012<sup>2</sup>:

2

S1\_K2 "Krime kundër jetës të kryera me dashje"; S2\_K2 "Krime kundër jetës shkakuar me pakujdesi"; S3\_K2 "Vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit"; S4\_K2 "Vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia"; S5\_K2 "Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës"; S6\_K2 "Krime seksuale"; S7\_K2 "Vepra penale kundër lirisë së personit"; S8\_K2 "Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit"; S9\_K2 "Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes"; S10\_K2 "Vepra penale kundër lirisë së besimit"; S11\_K3 "Vjedhja e pasurisë"; S2\_K3 "Mastrimet"; S3\_K3 "Shkatërrimi i pronës"; S4\_K3 "Vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare"; S5\_K3 "Krime në fushën e doganave"; S6\_K3 "Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet"; S7\_K3 "Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë"; S8\_K3 "Falsifikimi i dokumenteve"; S9\_K3 "Vepra penale në fushën e falimentimit"; S10\_K3 "Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit"; S11\_K3 "Vepra penale që cenojnë regjimin juridik të tokës"; S1\_K5 "Krime kundër pavarësisë dhe integritetit"; S2\_K5 "Krime kundër rendit kushtetues"; S1\_K8 "Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit"; S2\_K8 "Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik"; S3\_K8 "Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike"; S4\_K8 "Vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë";



Më poshtë paraqitet analizë e strukturës së kriminalitetit sipas ndarjes në krime dhe kundërvajtje penale për vitin 2012 duke përfshirë të dhëna që lidhen me procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë nga sipas veprave penale të parashikuar nga Kodi Penal.



### **TË DHËNA NË LIDHJE ME NJOFTIMET PËR VEPRAT PENALE**

Bazuar në të dhënat statistikore rezultojnë se në vitin 2011 janë filluar kryesisht 301 procedime penale nga ana e prokurorit, që do të thotë ulje prej 44,1% (për qind) në krahasim me vitin 2011. Kallëzime nga nëpunësit publikë, në vitin 2012 rezultojnë të jetë 1134 kallëzime, që do të thotë rritje prej 60,4% (për qind) në krahasim me vitin 2011; ky tregues, për vitin 2010 rezultojnë 1134 kallëzime, që do të thotë rritje prej 25,30% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Kallëzime nga personeli mjekësor, për vitin 2012 rezultojnë 4 kallëzime, për vitin 2011 rezultojnë 3 kallëzime; ndërkaq, për vitin 2010 rezultojnë 1 kallëzim, gjatë vitit 2009 dhe për vitin 2008 rezultojnë 5 kallëzime.

Kallëzime nga shtetasit, në vitin 2012 rezultojnë 2504 kallëzime që do të thotë rritje prej 39,03% në krahasim me vitin 2011; në vitin 2011, nga të dhënat statistikore rezultojnë 1801 kallëzime nga shtetasit, që do të thotë ulje prej 10,35% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në vitin 2010 rezultojnë 2009 kallëzime, që do të thotë ulje prej 14,80% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Kallëzime për vepra penale, që ndiqen mbi ankim, në vitin 2012 rezultojnë 500 ankime që do të thotë rritje prej 34,05% në krahasim me vitin 2011; në vitin 2011 rezultojnë 373 ankime, që do të thotë ulje prej 18,55% (për qind) në krahasim me vitin 2010, ndërsa në vitin 2010 rezultojnë 458, që do të thotë rritje prej 118% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Gjatë vitin 2012 është marrë njoftim për 4717 ngjarje, që do të thotë rritje prej 61,87% në krahasim me vitin 2011; Gjatë vitit 2011 është marrë njoftim për 2916 ngjarje, që do të thotë rritje prej 18,29% (për qind) në krahasim me vitin 2010. Gjatë vitit 2010 është marrë njoftim për 2465 ngjarje, që do të thotë se është një tregues në ulje prej 3,71 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Gjithashtu, theksojmë se, gjatë vitit 2012 janë marrë 18325 referime nga policia e shtetit, që do të thotë rritje prej 32,82% në krahasim me vitin 2011; gjatë vitit 2011 janë marrë 13828 referime nga policia e shtetit, që do të thotë rritje e lehtë prej 0,4% (për qind) në krahasim me vitin 2010. Gjatë viti 2010 janë marrë 13772 referime nga policia e shtetit, që do të thotë ulje prej 3,94% (për qind) në krahasim me vitin 2009; gjatë vitit 2009 janë marrë 14337 referime nga policia e shtetit, përkundërt vitit 2008 kur janë marrë 14529 referime nga policia e shtetit, që do të thotë se vihet re ulje e tyre gjatë vitit 2009 prej 1,32% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Gjatë vitit 2012 janë marrë 138 kallëzime nga policia tatimore, që do të thotë rritje prej 64,28% në krahasim me vitin 2011; gjatë vitit 2011 janë marrë 84 kallëzime nga organet tatimore. Gjatë vitit 2010 janë marrë 85 kallëzime nga organet tatimore që do të thotë rritje prej 21,42% (për qind) në krahasim me vitin 2009. Gjatë vitit 2009 janë marrë 70 kallëzime nga organet tatimore, përkundërt vitit 2008 kur janë marrë 32 kallëzime nga organet tatimore, që do të thotë se vihet re rritje e tyre gjatë vitit 2009 prej 2,18 herë në krahasim me vitin 2008.

Gjatë vitit 2012 janë bërë 192 kallëzime nga policia pyjore, që do të thotë rritje prej 3,78% në krahasim me vitin 2011; gjatë vitit 2011 janë bërë 185 kallëzime nga policia Pyjore, që do të thotë rritje prej 18,58% (për qind) në krahasim me vitin 2010. Gjatë vitit 2010 janë bërë 156 kallëzime nga Policia Pyjore, që do të thotë ulje prej 19,58% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Gjatë vitit 2012 janë bërë 350 kallëzime nga CEZ, që do të thotë ulje prej 53,08% në krahasim me vitin 2011; gjatë vitit 2011 janë bërë 746 kallëzime nga CEZ, që do të thotë rritje prej 13,03% (për qind) në krahasim me vitin 2010. Gjatë vitit 2010 janë bërë 660 kallëzime nga OSSH/CEZ, që do të thotë rritje prej rreth 5,2 herë në krahasim me vitin 2009. Gjatë vitit 2009 janë bërë 106 kallëzime nga OSSH, përkundërt vitit 2008 kur janë marrë 391 kallëzime nga OSSH, që do të thotë se vihet re ulje e ndjeshme e tyre gjatë vitit 2009 prej 72,89% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Gjithashtu, janë bërë 33 kallëzime nga polici të tjera, që do të thotë ulje prej 51% në krahasim me vitin 2011; gjatë vitit 2011 janë bërë 67 kallëzime nga “polici të tjera”, që do të thotë rritje prej 26,41% (për qind) në krahasim me vitin 2010. Gjatë vitit 2010, janë bërë 53 kallëzime nga “polici të tjera” gjatë vitit 2010, që do të thotë rritje prej 26,19% (për qind) në krahasim me vitin 2009 kur janë bërë 42 kallëzime pranë organit të prokurorisë edhe nga “polici të tjera” gjatë vitit 2009 dhe rreth 62 kallëzime gjatë vitit 2008.



**TREGUESIT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE PENALE TË FORMËS SË PRERË DHE TË MBIKËQYRJES SË VUAJTJES SË DËNIMIT**

Funksion i organit të prokurorisë është edhe ekzekutimi i vendimeve penale. Për të gjitha vendimet gjyqësore të formës së prerë organi i prokurorisë ka urdhëruar ekzekutimin e tyre.

Gjatë vitit 2012, prokurorët kanë urdhëruar ekzekutimin e 10835 vendimeve penale të formës së prerë, që do të thotë rritje prej 18,60% (për qind) në krahasim me vitin 2011. Nga këto vendime, janë ekzekutuar nga policia gjyqësore dhe përmbarimi 5127 vendime penale të formës së prerë, ose një rritje e theksuar prej 39,51% (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Vendime të cilët kanë mbetur pa u ekzekutuar (ku përfshihen edhe vendimet e mbartura të paekzekutuara), gjatë vitit 2012 janë 5374, që do të thotë ulje prej 2,82% (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Në lidhje me këtë tregues rezulton se gjatë vitit 2012 kanë mbetur pa u ekzekutuar 3 vendime për masën e dënimit burgim i përjetshëm; 891 vendime me burgim gjatë vitit 2012; 2775 vendime për dënimin me gjobë dhe 221 dënime plotësuese në vitin 2012.

Në vitin 2012 janë mbartur 5040 vendime, që do të thotë rritje prej 16,55% në krahasim me vitin 2011.


Një tregues tjetër lidhet me vendin që zënë urdhrat për ekzekutim të lëshuar nga prokurori për dënime alternative dhe urdhrat për ekzekutim në lidhje me dënimin me burgim.

Në lidhje me këtë tregues, rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2012 urdhrat për ekzekutim të dënimeve alternative zënë 24,3% të totalit të urdhrave për ekzekutim të lëshuara nga prokurori.

Urdhra për ekzekutim të dënimeve me burgim zënë 75,69% (për qind) të totalit të urdharev për ekzekutim të lëshuara nga prokurori në vitin 2012.

Në lidhje me këtë tregues, rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2011, urdhrat për ekzekutim të dënimeve alternative zënë 22% (për qind) të totalit të urdhrave për ekzekutim të lëshuara nga prokurori (këtu përfshihen, urdhra për ekzekutimin e dënimeve me burgim të përjetshëm, me burgim, me gjobë, dënime plotësuese dhe dënime alternative). Urdhrat për ekzekutim të dënimeve me burgim zënë 36,26% (për qind) të totalit të urdhrave për ekzekutim të lëshuara nga prokurori.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



**VEPRAT PENALE KUNDËR PERSONIT, KRIME KUNDËR JETËS  
KREU II, SEKSIONI I, “KRIME KUNDËR JETËS TË KRYERA ME DASHJE”**

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2012 është 2,76 % (për qind), për vitin 2011 3,28 % (për qind) përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2012 në krahasim me vitin 2011.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun II, Seksioni I, “Krime kundër jetës të kryera me dashje”.

| V.P. KUNDËR PERSONIT                        | 2011           |                      |                  |                     |                 | 2012            |                      |                   |                      |                 |
|---|----------------|----------------------|------------------|---------------------|-----------------|-----------------|----------------------|-------------------|----------------------|-----------------|
|   | Nr. Procd Regj | Nr. procd per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Procd. Regj | Nr. procd per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 76 Vrasja                              | 190            | 97                   | 132              | 114                 | 90              | 107             | 57                   | 90                | 71                   | 84              |
| Neni 77 Vrasja për një krim tjetër          | 0              | 0                    | 0                | 0                   | 2               | 0               | 1                    | 0                 | 1                    | 1               |
| Neni 78 Vrasja me paramendim                | 72             | 24                   | 66               | 28                  | 54              | 65              | 29                   | 46                | 38                   | 48              |
| Neni 79 Vrasja në rrethana cilësuese        | 46             | 26                   | 54               | 42                  | 43              | 72              | 31                   | 77                | 36                   | 35              |
| Neni 80                                     | 1              | 0                    | 0                | 0                   | 0               | 2               | 0                    | 0                 | 0                    | 0               |
| Neni 81 Vrasja e foshnjës                   | 4              | 0                    | 1                | 0                   | 0               | 1               | 0                    | 0                 | 0                    | 0               |
| Neni 82 Vrasja në tronditje psikike         | 4              | 5                    | 4                | 6                   | 4               | 4               | 5                    | 4                 | 5                    | 6               |
| Neni 83 Në kapërcim mbrojtjes nevojshme     | 1              | 2                    | 1                | 2                   | 3               | 7               | 8                    | 7                 | 8                    | 6               |
| Neni 83/a Kanosje për hakmarrje/ gjakmarrje | 3              | 0                    | 3                | 0                   | 0               | 4               | 0                    | 2                 | 0                    | 0               |
| Neni 83/b Nxitja për gjakmarrje             | 0              | 0                    | 0                | 0                   | 0               | 0               | 0                    | 0                 | 0                    | 0               |
| Neni 84 Kanosja                             | 327            | 125                  | 198              | 137                 | 146             | 348             | 114                  | 186               | 124                  | 113             |
| <b>Totali</b>                               | <b>648</b>     | <b>279</b>           | <b>459</b>       | <b>329</b>          | <b>342</b>      | <b>610</b>      | <b>245</b>           | <b>412</b>        | <b>283</b>           | <b>293</b>      |

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2012 ka një ulje prej 5,86 % (për qind) të numrit të procedimeve të regjistruara për “Krime Kundër Jetës të Kryera me Dashje” në krahasim me vitin 2011. Ndërkaq kemi ulje prej 12,18 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2011. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2011 prej 10,23 % (për qind); një ulje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 13,98 % (për qind) dhe kemi ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 14,32 % (për qind) përkundrejt vitit 2011.

## **TE PANDEHURIT**

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2012 në total janë 663 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2011 në total kanë qenë 609 të pandehur në hetim. Pra, në këtë tregues vihet re rritje prej 8,86% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2012 në krahasim me vitin 2011.

Nga të pandehurit, 42 kanë qenë të pandehur të mitur meshkuj dhe 2 femra; të pandehur të rritur (mbi 18 vjec) 11 femra dhe 415 meshkuj.

Në këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2011 rezulton rritje e të pandehurve meshkuj të mitur 14-18 vjec në vitin 2012, rezultojnë 42 të tillë, përkundrajt 36 të mitur meshkuj në vitin 2011.

Në vitin 2012 nuk rezultojnë asnjë shtetas i huaj i pandehur në vitin 2012.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 341 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 117 me arsim të mesëm dhe 10 të pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë rregjistruar 13 të pandehur përkundrajt 11 të tillë në vitin 2011. Nga këta, 1 i pandehur është nëpunës i nivelit të lartë, dhe 1 i pandehur është nëpunës i nivelit të mesëm. 11 të pandehur janë nëpunës të thjeshtë. Nga sektori privat janë rregjistruar 116 të pandehur (ritje prej 46,83% për qind) në krahasim me vitin 2011 dhe të papunë 262 (ulje prej 9,96% (për qind) në krahasim me vitin 2011. Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Rezulton se 198 të pandehur kanë vendbanimin në qytet (ulje prej 21,11 % (për qind) në krahasim me vitin 2011 I këtij treguesi; ndërsa 258 prej tyre në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat rurale.

Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 398 të pandehur, vetëm 3 prej tyre janë përsëritës për të njëjtën vepër penale, ndërsa 40 të pandehur janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

Të dëmtuar-viktima në këtë grup veprash penale rezultojnë 13 meshkuj të mitur (mosha 14-18 vjec) dhe gjithsej 152 meshkuj madhorë, ndërsa 19 janë femra.

Pasojat në dëm të shëndetit rezultojnë me 129 vdekje, 56 plagosje e rëndë dhe 46 plagosje e lehtë.


## **TENDENCA**

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të rregjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal “Vrasja”, në vitin 2012, prej 43,68 % (për qind) në krahasim me vitin 2011.




Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “**Krime kundër jetës të kryera me dashje**” është 17,54 % (për qind) për vitin 2012, ndërkohë që në vitin 2011 ka qenë 29,32% (për qind).

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2008-2012 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 ka ulje prej 23,5% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2010 ka rritje prej 3,64% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2011 ka ulje prej 4,52% (për qind) në krahasim me vitin 2010 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2012 ka ulje prej 43,68% (për qind) në krahasim me vitin 2011 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 76 “Vrasja” i Kodit Penal.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) sipas rretheve për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal “Vrasja” për vitin 2012.




Në një këndvështrim krahasues, rezulton se në prokurorinë e rrethit gjyqësor Durrës në vitin 2012 është regjistruar 1 procedim penal për këtë veprë penale, ndërkohë që në vitin 2011 janë regjistruar 11 procedime penale; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Elbasan rezulton një ulje e theksuar e procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale. Kështu, në vitin 2012 janë regjistruar 4 procedime penale, përkundrejt 19 procedimeve të regjistruara në vitin 2011; me ulje rezultojnë procedimet penale edhe në prokurorinë e rrethit gjyqësor Fier kun ë vitin 2012 janë regjistruar 2 procedime penale, përkundrejt 19 të tilla në vitin 2011; në Kurbin, në vitin 2012 janë regjistruar 6 procedime penale dhe në vitin 2011 janë regjistruar 11 procedime penale; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Korçë, në vitin 2012 janë regjistruar 9 procedime penale dhe në vitin 2011 janë regjistruar 4 procedime penale për vrasje; në Sarandë në vitin 2012 është regjistruar 1 procedim penal dhe në vitin 2011 janë regjistruar 5 procedime penale; në Shkodër, në vitin 2012 është regjistruar 1 procedim penal dhe në vitin 2011 janë regjistruar 24 procedime penale; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë në vitin 2012 janë regjistruar 23 procedime penale, përkundrejt 34 procedime të regjistruara në vitin 2011 për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal “Vrasja”.

## TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të rregjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal “Vrasja me Paramendim”, në vitin 2012, prej 9,72 % (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “**Krime kundër jetës të kryera me dashje**” është 10,65 % (për qind) për vitin 2012, ndërkohë që në vitin 2011 ka qenë 11,11% (për qind).


Ecuria e kësaj veprave penale në pesë vite, 2008-2012 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Rezultoni nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 ka rritje prej 7,79% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2010 ka ulje prej 30,12% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2011 ka rritje prej 24,13% (për qind) në krahasim me vitin 2010 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2012 ka ulje prej 9,72% (për qind) në krahasim me vitin 2011 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 78 “Vrasja me paramendim” i Kodit Penal.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezultoni nga të dhënat statistikore se në prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë janë regjistruar 11 procedime penale për këtë vepër penale; në Lezhë janë regjistruar 8 procedime penale; në prokuroritë e retheve gjyqësore Shkodër dhe Fier janë regjistruar nga 7 procedime penale; 6 procedime penale janë regjistruar në prokurorinë e rrethit gjyqësor Durrës; 5 procedime janë regjistruar në Vlore dhe nga 4 procedime penale janë regjistruar në Mat dhe Berat.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me numrin e procedimeve penale të regjistruara në vitin 2012 për nenin 78 të Kodit Penal “Vrasja me paramendim”.




**TENDENCA**

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të rregjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 79 i Kodit Penal “Vrasja në rrethana rënduese”, në vitin 2012, prej 56,52 % (për qind) në krahasim me vitin 2011.


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “**Krime kundër jetës të kryera me dashje**” është 11,8 % (për qind) për vitin 2012, ndërkohë që në vitin 2011 ka qenë 7,09% (për qind).

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2008-2012 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë):



Rezultoni nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 ka ulje prej 19,35% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2010 ka rritje prej 48% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2011 ka rritje prej 24,32% (për qind) në krahasim me vitin 2010 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2012 ka rritje prej 56,52% (për qind) në krahasim me vitin 2011 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 79 “Vrasja në rrethana rënduese” i Kodit Penal.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me procedimet penale të regjistruara në vitet 2011 dhe 2012 për veprën penale të parashikuar nga neni 79 i Kodit penal “Vrasja në rrethana rënduese”.




## TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 83 i Kodit Penal “Vrasja në kapërcim të mbrojtjes së nevojshme”, në vitin 2012, janë regjistruar 7 procedime penale dhe në vitin 2011 është regjistruar vetëm 1 procedim penal

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2008-2012 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë). Sikurse vihet re, në vitin 2009 janë regjistruar 5 procedime penale; në vitin 2008, 2010 dhe në vitin 2011 është regjistruar nga 1 procedim penal dhe në vitin 2012 janë regjistruar 7 procedime pemale për veprën penale të parashikuar nga neni 83 i Kodit Penal “Vrasja në kapërcim të mbrojtjes së nevojshme”.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezultoni nga të dhënat statistikore se rrethet Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Kurbin, Lezhë dhe Tiranë kanë regjistruar nga 1 procedim penal në vitin 2012 për veprën penale të parashikuar nga neni 83 i Kodit Penal “Vrasja në kapërcim të mbrojtjes së nevojshme”.



**KREU II, SEKSIONI II  
KRIME KUNDËR JETËS SHKAKTUAR ME PAKUJDESI**

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun e II-të, Seksioni i II “Krime kundër jetës shkaktuar me pakujdesi”:

| KRIME KUNDËR<br>JETËS SHKAKTUAR<br>ME PAKUJDESI | 2011           |                      |                  |                     |                 | 2012            |                      |                   |                      |                 |
|---|----------------|----------------------|------------------|---------------------|-----------------|-----------------|----------------------|-------------------|----------------------|-----------------|
|   | Nr. Procd Regj | Nr. procd per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Procd. Regj | Nr. procd per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 85 Vrasja nga pakujdesia                   | 13             | 8                    | 10               | 8                   | 7               | 9               | 5                    | 7                 | 5                    | 8               |
| <b>Totali</b>                                   | <b>13</b>      | <b>8</b>             | <b>10</b>        | <b>8</b>            | <b>7</b>        | <b>9</b>        | <b>5</b>             | <b>7</b>          | <b>5</b>             | <b>8</b>        |

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2012 ka një ulje prej 30,76 % (për qind) të numrit të procedimeve të rregjistruara për “Krime kundër jetës të shkaktuar me pakujdesi” në krahasim me vitin 2011. Ndërkaq kemi ulje prej 37,5 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2011. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të rregjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2011 prej 30 % (për qind); një ulje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 37,5 % (për qind) dhe kemi rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 14,28 % (për qind) përkundrejt vitit 2011.

**TË PANDEHURIT**

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2012 në total janë 11 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2009 në total kanë qenë 12

të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re një ulje e lehtë në krahasim me vitin 2011.

Nga të pandehurit, 1 ka qenë i pandehur i mitur mashkull dhe asnjë femër; të pandehur të rritur (mbi 18 vjec) asnjë femër dhe 11 meshkuj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 11 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku të gjithë të pandehurit rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej 8 të pandehur rezultojnë të jenë të papunë.

Rezulton se 7 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 4 prej tyre në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.


Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se të gjithë të pandehurit, 11, janë të padënuar më parë.

## **TENDENCA**

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të rregjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal “Vrasja nga pakujdesia”, në vitin 2012, prej 30,76 % (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime kundër jetës shkaktuar me pakujdesi” është 0,04 % (për qind) për vitin 2012, ndërkohë që në vitin 2011 ka qenë 0,06% (për qind).

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2008-2012 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë):



Rezultoni nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 ka ulje prej 17,39% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2010 ka ulje prej 15,78% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2011 ka ulje prej 18,75% (për qind) në krahasim me vitin 2010 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2012 ka ulje prej 30,76% (për qind) në krahasim me vitin 2011 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 85 “Vrasja nga pakujdesia” i Kodit Penal.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale, rezultoni nga të dhënat statistikore se në prokuroritë e rretheve gjyqësore Elbasan, Fier, Gjirokastrë dhe Kukës është regjistruar nga 1 procedim penal në vitin 2012; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Shkodër janë regjistruar 2 procedime penale dhe në prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë janë regjistruar 3 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal “Vrasja nga pakujdesia”.

**KREU II, SEKSIONI IV  
VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA NGA PAKUJDESIA**

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun e II-të, Seksioni i IV “Vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia”:

| VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA NGA PAKUJDESIA | 2011            |                      |                   |                      |                 | 2012           |                      |                  |                     |                 |
|--|-----------------|----------------------|-------------------|----------------------|-----------------|----------------|----------------------|------------------|---------------------|-----------------|
|  | Nr. Procd. Regj | Nr. procd per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Procd Regj | Nr. procd per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 91 Plagosje e rëndë nga pakujdesia                | 6               | 3                    | 4                 | 3                    | 3               | 5              | 0                    | 1                | 0                   | 0               |
| Neni 92 Plagosja e lehtë nga pakujdesia                | 0               | 0                    | 0                 | 0                    | 0               | 3              | 0                    | 1                | 0                   | 0               |
| Totali   | 6               | 3                    | 4                 | 3                    | 3               | 8              | 0                    | 2                | 0                   | 0               |



## **Raport i Prokurorit të Përgjithshëmmbi Gjendjen e Kriminalitetit**

**Për vitin 2012**

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2012 janë regjistruar 8 procedime penale për këtë grup veprash penale dhe janë regjistruar 2 të pandehur.

### **KREU II, SEKSIONI V, “VEPRA PENALE QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E SHTATZANISË OSE MOSHDËNIA E NDIHMËS”**

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2012 është 041 % (për qind), për vitin 2011 0,57 % (për qind) përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një ulje e lehtë e këtij treguesi për vitin 2012 në krahasim me vitin 2011.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në seksionin v te kreut të dytë “Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës”.

| V. P. QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E SHTATZANISË OSE NGA MOSHDËNIA E NDIHMËS | 2011            |                      |                   |                      |                 | 2012            |                      |                   |                      |                 |
|--|-----------------|----------------------|-------------------|----------------------|-----------------|-----------------|----------------------|-------------------|----------------------|-----------------|
|  | Nr. Procd. Regj | Nr. procd per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Procd. Regj | Nr. procd per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 93 Ndërprerja e shtatzanisë pa pëlqim të gruas  | 3               | 0                    | 0                 | 0                    | 0               | 1               | 0                    | 0                 | 0                    | 0               |
| Neni 94 Ndërprerja e shtatzanisë e kryer në vende dhe nga persona të paautoriz.                  | 2               | 0                    | 0                 | 0                    | 0               | 0               | 0                    | 0                 | 0                    | 0               |
| Neni 95 Dhënia e mjeteve për ndërprerjen e shtatzanisë   | 0               | 0                    | 0                 | 0                    | 0               | 0               | 0                    | 0                 | 0                    | 0               |
| Neni 96 Mjekimi i pakujdesshëm   | 21              | 7                    | 7                 | 13                   | 6               | 25              | 0                    | 1                 | 0                    | 1               |
| Neni 97 Mosdhënia ndihmë   | 0               | 0                    | 0                 | 0                    | 0               | 1               | 1                    | 0                 | 1                    | 0               |
| Neni 98 Mosdhënia e ndihmës nga kapiteni i anijes  | 0               | 0                    | 0                 | 0                    | 0               | 0               | 0                    | 0                 | 0                    | 0               |
| Neni 99 Shkaktimi i vetëvrasjes  | 88              | 3                    | 4                 | 3                    | 2               | 65              | 2                    | 2                 | 2                    | 1               |
| <b>Totali</b>  | <b>114</b>      | <b>10</b>            | <b>11</b>         | <b>16</b>            | <b>8</b>        | <b>92</b>       | <b>3</b>             | <b>3</b>          | <b>3</b>             | <b>2</b>        |

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2012 ka një ulje prej 19,29 % (për qind) të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose nga mosdhënia e ndihmës” në krahasim me vitin 2011. Ndërkaq kemi ulje prej 70 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2011. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2012 prej 72,72 % (për qind); një ulje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 81,25 % (për

qind) dhe kemi ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 75 % (për qind) përkundrejt vitit 2011.

## **TË PANDEHURIT**

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2012 në total janë 8 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2011 në total kanë qenë 18 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re ulje prej 55,55% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2012 në krahasim me vitin 2011.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 3 të pandehur janë me arsim të mesëm dhe 4 të pandehur me arsim të lartë.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë rregjistruar 2 të pandehur (që do të thotë ulje prej 83,33 % (për qind) në krahasim me vitin 2010). Nga këta, 2 të pandehur janë nëpunës i thjeshtë.

Nga sektori privat janë rregjistruar 3 të pandehur përkundrejt 1 të pandehuri në vitin 2011.

Rezulton se 6 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 1 prej tyre në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.

Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë të gjitha të pandehurit janë të padënuar më parë.

Të dëmtuar-viktima në këtë grup veprash penale rezultojnë 2 femra të mitura (mosha 14-18 vjec); gjithsej 19 meshkuj madhorë (ulje prej 9,52% në krahasim me vitin 2011, ndërsa 9 janë femra madhore (të rritur mbi 18 vjec), përkundrejt 6 të tilla në vitin 2011.


Pasojat në dëm të shëndetit rezultojnë me 28 raste vdekje, 2 plagosje e rëndë dhe asnjë plagosje e lehtë. Në lidhje me këtë tregues jemi pothuajse në të njëjtat nivele sikurse në vitin 2011.

## **TENDENCA**

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të rregjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal “Shkaktimi i vetëvrasjes”, në vitin 2012, prej 26,13 % (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakudësia” është 70,65 % (për qind) për vitin 2012, ndërkohë që në vitin 2011 ka qenë 77,19% (për qind).


Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2008-2012 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë):



Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 ka rritje prej 15,70% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2010 ka ulje prej 60% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2011 është regjistruar I njëjti numër procedimesh penale sikurse dhe në vitin 2010 dhe në vitin 2012 ka ulje prej 26,13% (për qind) në krahasim me vitin 2011 të procedimeve penale të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 99 “Shkaktimi i vetëvrasjes” i Kodit Penal.

Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të rregjistruara në shkallë vendi për veprën penale të parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal “Shkaktimi i vetëvrasjes”. Rrethet të cilat nuk figurojnë në grafik nuk kanë regjistruar asnjë procedim penal për këtë vepër penale gjatë vitit 2012.

**Shpërndarja gjeografike Neni 99 "Shkaktimi i vetëvrasjes"**



Rezulton nga të dhënat statistikore se në prokuroritë e rretheve gjyqësore Kavajë, Kukës, Pukë, Sarandë dhe Vlorë është regjistruar nga 1 procedim penal për këtë veprë penale në vitin 2012; në prokuroritë e rretheve gjyqësore Dibër, Lushnje dhe Mat janë regjistruar nga 2 procedime penale për këtë veprë penale; në Tropojë janë regjistruar 3 procedime penale; në Krujë janë regjistruar 5 procedime penale; në prokuroritë e rretheve gjyqësore Durrës dhe Lezhë janë regjistruar nga 6 procedime penale gjate vititi 2012; në Berat dhe Fier janë regjistruar janë regjistruar nga 7 procedime penale; në pogradec janë regjistruar 8 procedime dhe në Shkodër janë regjistruar 12 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 99 I Kodit Penal “Shkaktimi i vetëvrasjes” në vitin 2012.

**KRIME SEKSUALE  
SEKSIONI IV**

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2012 është 0,23 % (për qind), për vitin 2011 0,24 % (për qind) përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një ulje e lehtë e këtij treguesi për vitin 2012 në krahasim me vitin 2011.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e VI të Kodit Penal “Krime Seksuale”:

| KRIME SEKSUALE     |                       | 2011                |                      |                    |                    | 2012                  |                     |                      |                    |
|--------------------|-----------------------|---------------------|----------------------|--------------------|--------------------|-----------------------|---------------------|----------------------|--------------------|
| Nr. Proc. d. Regj. | Nr. proced per gjykim | Nr. i pan. d. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand. denu. ar | Nr. Proc. d. Regj. | Nr. proced per gjykim | Nr. i pan. d. Regj. | Nr. Pand. per gjykim | Nr. Pand. denu. ar |
|                    |                       |                     |                      |                    |                    |                       |                     |                      |                    |

## **Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi Gjendjen e Kriminalitetit**

### **Për vitin 2012**

|   |           |           |           |           |           |           |           |           |           |           |
|---|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|
| Neni 100 M. Sek/ homoseksuale me të mitur                                       | 14        | 7         | 13        | 8         | 7         | 17        | 10        | 17        | 13        | 12        |
| Neni 101 M. Sek/ homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës me 14-18 vjeç      | 12        | 5         | 9         | 10        | 5         | 7         | 0         | 1         | 0         | 1         |
| Neni 102 M. Seksuale me dhunë me të rritura                                     | 13        | 2         | 9         | 2         | 2         | 14        | 5         | 11        | 6         | 5         |
| Neni 102/a M. Homoseksuale me dhunë me të rritur                                | 0         | 0         | 0         | 0         | 0         | 0         | 0         | 0         | 0         | 0         |
| Neni 103 M. Sek/ homoseksuale me persona te pazotë për t'u mbrojtur             | 3         | 0         | 1         | 0         | 1         | 6         | 1         | 1         | 1         | 0         |
| Neni 104 Marrëdhënie seksuale ose homoseksualeme kërkënim me përdorimin e armës |           |           |           |           |           | 0         | 0         | 0         | 0         | 0         |
| Neni 105 M. Sek/ homoseksuale duke shpërdoruar detyrën                          | 0         | 0         | 0         | 0         | 0         | 0         | 0         | 0         | 0         | 0         |
| Neni 106 M. Sek/ homoseksuale me persona në gjini ose në kujdestari             | 2         | 3         | 2         | 3         | 0         | 1         | 0         | 0         | 0         | 1         |
| Neni 107 M. Sek/ homoseksuale ne vende publike                                  | 0         | 0         | 0         | 0         | 0         | 0         | 0         | 0         | 0         | 0         |
| Neni 108 Vepra të turpshme  | 5         | 3         | 5         | 3         | 3         | 7         | 5         | 7         | 5         | 4         |
| <b>Totali</b>   | <b>49</b> | <b>20</b> | <b>39</b> | <b>26</b> | <b>18</b> | <b>52</b> | <b>21</b> | <b>37</b> | <b>25</b> | <b>23</b> |

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2012 ka një rritje prej 6,12 % (për qind) të numrit të procedimeve të rregjistruara për Krime Seksuale në krahasim me vitin 2011. Ndërkaq kemi rritje prej 5 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2011. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të rregjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2011 prej 5,12 % (për qind); një ulje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 3,84 % (për qind) dhe kemi rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 27,77 % (për qind) përkundrejt vitit 2011.

### **TE PANDEHURIT**

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2012 në total janë 47 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2011 në total kanë qenë 57 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re ulje prej 17,54% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2012 në krahasim me vitin 2011. Në vitin 2012 për 25 të pandehur është ngritur akuza në gjykatë, ndërkohë në vitin 2011 është ngritur akuza në gjykatë për 26 të pandehur.

Nga të pandehurit, 1 ka qenë i pandehur i mitur mashkull dhe asnjë femër; të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) 2 femra dhe 43 meshkuj.

Në këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2011 rezulton rritje e të pandehurve meshkuj në vitin 2012 prej 13,15% (për qind).

Rezultojnë 2 shtetas të huaj të pandehur për vitin 2012 për këtë grup veprash penale, ndërkohë që në vitin 2011 nuk është rregjistruar asnjë shtetas i huaj si i pandehur.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 34 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 12 me arsim të mesëm dhe asnjë i pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se nga sektori shtetëror nuk është regjistruar asnjë i pandehur

Nga sektori privat janë regjistruar 5 të pandehurpërkundrejt 3 të pandehur në vitin 2011.

Të papunë rezultojnë të jenë 32 të pandehur, që do të thotë rritje prej 33,33 % (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Rezulton se 25 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 21 prej tyre në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.

Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 39 të pandehur, vetëm 1 prej tyre është përsëritës për të njëjtën vepër penale, ndërsa 6 të pandehur janë përsëritës për vepra penale të ndryshme, përkundrejt 1 të tillë në vitin 2011.


Të dëmtuar-viktima në këtë grup veprash penale rezultojnë 9 femra të mitura (mosha 14-18 vjec) dhe gjithsej 6 femra madhore mbi 18 vjec.

## **TENDENCA**

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 101 i Kodit Penal “marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, në vitin 2012, prej 41,66 % (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime seksuale ” është 13,46 % (për qind) për vitin 2012, ndërkohë që në vitin 2011 ka qenë 24,48% (për qind).

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2008-2012 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



## Raport i Prokurorit të Përgjithshëmmbi Gjendjen e Kriminalitetit

Për vitin 2012

Rezultoni nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 ka ulje prej 30,43% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2010 ka ulje prej 43,75% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2011 ka rritje prej 33,33% (për qind) në krahasim me vitin 2010 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2012 ka ulje prej prej 41,66% (për qind) në krahasim me vitin 2011 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 101 “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18” i Kodit Penal.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezultoni nga të dhënat statistikore se në prokuroritë e rretheve gjyqësore Fier, Korçë, Pogradec, Tiranë dhe Vlorë është regjistruar nga 1 procedim penal për këtë veprën penale gjatë vitit 2012 dhe në prokurorinë e rrethit gjyqësor Berat janë regjistruar 2 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 101 i Kodit Penal “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18”.

### SEKSIONI VII VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË PERSONIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2012 është 0,38 % (për qind), për vitin 2011 0,41 % (për qind) përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2012 në krahasim me vitin 2011.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e VII “Vepra penale kundër lirisë së personit”.

| V.P. K/LIRISE SË PERSONIT  | 2011             |                       |                     |                      |                  | 2012            |                       |                     |                     |                  |
|--|------------------|-----------------------|---------------------|----------------------|------------------|-----------------|-----------------------|---------------------|---------------------|------------------|
|  | Nr. Proc d. Regj | Nr. proc d per gjykim | Nr. i pan d. Reg j. | Nr. Pand .Per gjykim | Nr. Pand denu ar | Nr. Proc d Regj | Nr. proc d per gjykim | Nr. i pan d. Reg j. | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denu ar |
| Neni 109 Rrembimi ose mbajtja peng e personit                              | 9                | 1                     | 3                   | 3                    | 3                | 9               | 2                     | 11                  | 8                   | 2                |
| Neni 109/a Rrembimi ose mbajtja peng e personit ne rrethana lehtesuese     | 0                | 0                     | 0                   | 0                    | 0                | 0               | 1                     | 0                   | 1                   | 1                |
| Neni 109/b Shtrengimi me ane te kanosjes ose dhunes per dhenien e pasurise | 22               | 6                     | 20                  | 15                   | 13               | 36              | 12                    | 34                  | 21                  | 22               |
| Neni 110 Heqja e paligjshme e lirisë                                       | 30               | 15                    | 37                  | 25                   | 33               | 30              | 13                    | 42                  | 30                  | 16               |
| Neni 111 Rrembimi i avioneve, anijeve dhe mjeteve te tjera                 | 0                | 0                     | 0                   | 0                    | 0                | 0               | 0                     | 0                   | 0                   | 0                |
| Neni 112 Dhunimi i banesës   | 20               | 6                     | 11                  | 11                   | 8                | 10              | 5                     | 6                   | 7                   | 8                |
| <b>Totali</b>  | <b>81</b>        | <b>28</b>             | <b>71</b>           | <b>54</b>            | <b>57</b>        | <b>85</b>       | <b>33</b>             | <b>93</b>           | <b>67</b>           | <b>49</b>        |

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezultoni se në vitin 2012 ka një rritje prej 4,93 % (për qind) të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale kundër lirisë së personit” në krahasim me vitin 2011. Ndërkaq kemi rritje prej 17,85 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2011. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2011 prej 30,98 % (për qind); një rritje të numrit të të pandehurve të cilët i

janë dërguar gjyqit prej 24,07 % (për qind) dhe kemi ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 14,03 % (për qind) përkundrejt vitit 2011.

## **TE PANDEHURIT**

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2012 në total janë 113 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2011 në total kanë qenë 103 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re rritje prej 9,7% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2012 në krahasim me vitin 2011. Në vitin 2012 për 67 të pandehur është ngritur akuza në gjykatë, ndërkohë që në vitin 2011 është ngritur akuza në gjykatë për 54 të pandehur që do të thotë një rritje e këtij treguesi për vitin 2012 prej 24,07% (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Nga të pandehurit, 2 kanë qenë të pandehur të mitur meshkuj dhe asnjë femër; të pandehur të rritur (mbi 18 vjec) 4 femra dhe 72 meshkuj.

Në këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2011 rezulton ulje e të pandehurve femra në vitin 2012 prej 50% (për qind).

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 48 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 30 me arsim të mesëm dhe asnjë i pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj veprash penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror nuk është rregjistruar asnjë i pandehur.

Nga sektori privat janë rregjistruar 30 të pandehur (ulje prej 18,91% për qind) në krahasim me vitin 2011 dhe të papunë 38 (ulje prej 11,62% (për qind) në krahasim me vitin 2011. Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj veprash penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Rezulton se 38 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 40 prej tyre në komuna.

Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 47 të pandehur, vetëm 3 prej tyre janë përsëritës vepra penale të ndryshme.

## **TENDENCA**


Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të rregjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 109/b i Kodit Penal “Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhnunës për dhënien e pasurisë”, në vitin 2012, prej 63,63 % (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër lirisë së personit” është 42,35 % (për qind) për vitin 2012, ndërkohë që në vitin 2011 ka qenë 27,16% (për qind).



Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2008-2012 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë):

**Neni 109/b "Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë"**



Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 ka rritje prej 100% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2010 ka ulje prej 66,66% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2011 ka rritje prej 175% (për qind) në krahasim me vitin 2010 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2012 ka rritje prej 63,63% (për qind) në krahasim me vitin 2011 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 109/b “Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë” i Kodit Penal.


Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezulton nga të dhënat statistikore se në prokurorinë e rrethit gjyqësor Durrës janë regjistruar 4 procedime penale në vitin 2012, përkundrajt vitit 2011 kur nuk është regjistruar asnjë procedim penal; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Elbasan janë regjistruar 2 procedime penale për këtë veprë penale në vitin 2012, ndërkohë që në vitin 2011 nuk është regjistruar asnjë procedim penal; në prokuroritë e rretheve gjyqësore Korçë, Lushnje dhe Shkodër është regjistruar nga 1 procedim penal në vitin 2012 dhe në prokurorinë për krime të rënda janë regjistruar 27 procedime penale për këtë veprë penale, përkundrajt 15 procedimeve penale të regjistruara në këtë prokurori në vitin 2011.

## **TENDENCA**

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të rregjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 112 i Kodit Penal “Dhunimi i banesës”, në vitin 2012, prej 50 % (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Kundër lirisë së personit” është 11,76 % (për qind) për vitin 2012, ndërkohë që në vitin 2011 ka qenë 24,69% (për qind).

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2008-2012 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 ka ulje prej 16% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2010 ka ulje prej 33,33% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2011 ka rritje prej 42,85% (për qind) në krahasim me vitin 2010 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2012 ka ulje prej 50% (për qind) në krahasim me vitin 2011 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 112 “Dhunimi i banesës” i Kodit Penal.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, për këtë veprë penale nga të dhënat statistikore rezulton se në prokuroritë e rretheve gjyqësore janë regjistruar nga 2 procedime penale në vitin 2012; në prokuroritë e rretheve gjyqësore Tiranë dhe Elbasan është regjistruar nga 1 procedim penal për këtë veprë penale dhe në prokurorinë e rrethit gjyqësor Fier janë regjistruar 4 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 112 i Kodit Penal “Dhunimi i banesës”.

## **SEKSIONI VIII VEPRA PENALE KUNDËR MORALIT DHE DINJITETIT**

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2012 është 0,37 % (për qind), për vitin 2011 0,54 % (për qind) përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2012 në krahasim me vitin 2011.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e VIII të Kodit Penal “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit”.

## **Raport i Prokurorit të Përgjithshëmmbi Gjendjen e Kriminalitetit**

**Për vitin 2012**

| VEPRA PENALE KUNDËR MORALIT<br>DHJE DINJITETIT                   | 2011                   |                             |                             |                              |                           | 2012                   |                             |                            |                             |                           |
|--|------------------------|-----------------------------|-----------------------------|------------------------------|---------------------------|------------------------|-----------------------------|----------------------------|-----------------------------|---------------------------|
|  | Nr. Proce<br>d<br>Regj | Nr. proce<br>d per<br>gjkim | Nr. i<br>pand<br>.<br>Regj. | Nr.<br>Pand.<br>Per<br>gjkim | Nr.<br>Pand<br>denu<br>ar | Nr. Proce<br>d<br>Regj | Nr. proce<br>d per<br>gjkim | Nr. i<br>pan<br>d.<br>Regj | Nr.<br>Pand<br>per<br>gjkim | Nr.<br>Pand<br>denu<br>ar |
| Neni 113 Prostitucioni   | 18                     | 16                          | 21                          | 28                           | 26                        | 10                     | 8                           | 34                         | 18                          | 20                        |
| Neni 114 Shfrytëzimi i prostitucionit                            | 30                     | 7                           | 12                          | 13                           | 17                        | 19                     | 5                           | 10                         | 9                           | 9                         |
| Neni 114/a Shfrytëzimi i prostitucionit në<br>rrethana rënduese  | 33                     | 11                          | 25                          | 20                           | 20                        | 18                     | 5                           | 11                         | 10                          | 14                        |
| Neni 115 Mbajtja e lokaleve për prostitucion                     | 2                      | 1                           | 5                           | 2                            | 4                         | 0                      | 0                           | 0                          | 0                           | 3                         |
| Neni 117 Pornografia   | 0                      | 0                           | 0                           | 0                            | 0                         | 0                      | 0                           | 0                          | 0                           | 0                         |
| Neni 118 Dhunimi i varreve                                       | 17                     | 7                           | 9                           | 10                           | 12                        | 26                     | 5                           | 6                          | 6                           | 5                         |
| Neni 119 Fyerja  | 4                      | 0                           | 1                           | 0                            | 1                         | 5                      | 1                           | 3                          | 1                           | 0                         |
| Neni 120 Shpifja   | 0                      | 0                           | 0                           | 0                            | 0                         | 0                      | 0                           | 0                          | 0                           | 0                         |
| Neni 121 Ndërhyrje të padrejta në jetën<br>private               | 2                      | 0                           | 0                           | 0                            | 0                         | 2                      | 0                           | 0                          | 0                           | 0                         |
| Neni 122 Përhapja e sekreteve vetjake                            | 0                      | 0                           | 0                           | 0                            | 0                         | 0                      | 0                           | 0                          | 0                           | 0                         |
| Neni 123 Pengimi ose shkelja e fshehtësisë së<br>korrespondencës | 2                      | 1                           | 1                           | 1                            | 1                         | 2                      | 1                           | 1                          | 1                           | 2                         |
| <b>Totali</b>  | <b>108</b>             | <b>43</b>                   | <b>74</b>                   | <b>74</b>                    | <b>81</b>                 | <b>82</b>              | <b>25</b>                   | <b>65</b>                  | <b>45</b>                   | <b>53</b>                 |

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2012 ka një ulje prej 24,07 % (për qind) të numrit të procedimeve të rregjistruara për “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit” në krahasim me vitin 2011. Ndërkaq kemi ulje prej 41,86 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2011. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të rregjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2011 prej 12,16 % (për qind); një ulje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 39,18 % (për qind) dhe kemi ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 34,56 % (për qind) përkundrejt vitit 2011.

### **TE PANDEHURIT**

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2012 në total janë 96 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2011 në total kanë qenë 105 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re ulje prej 8,57% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2012 në krahasim me vitin 2011.

Nga të pandehurit, 3 kanë qenë të pandehur të mitur meshkuj dhe asnjë femër; të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) 40 femra dhe 41 meshkuj.

Në këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2011 rezulton rritje e të pandehurve femra në vitin 2012 prej 53,84% (për qind).

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 74 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar (që do të thotë rritje prej 17,46% në krahasim me vitin 2011) dhe 8 me arsim të mesëm dhe asnjë i pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj

vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjecar.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror është rregjistruar 1 i pandehur nëpunës i thjeshtë.

Nga sektori privat janë rregjistruar 9 të pandehur përkundrejt 3 të tillë në vitin 2011 dhe të papunë 55 (rritje prej 41,02% (për qind) në krahasim me vitin 2011. Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Rezulton se 54 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ulje prej 10% në krahasim me vitin 2011) ndërsa 30 prej tyre në komuna (rritje prej 76,47% (për qind) në krahasim me vitin 2011).


Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 72 të pandehur, vetëm 1 prej tyre është përsëritës për të njëjtën vepër penale, ndërsa 2 të pandehur janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

## **TENDENCA**

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të rregjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 113 i Kodit Penal “Prostitucioni”, në vitin 2012, prej 44,44 % (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit” është 12,19 % (për qind) për vitin 2012, ndërkohë që në vitin 2011 ka qenë 16,66% (për qind).

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2008-2012 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë):



Rezultoni nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 ka rritje prej 37.03% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2010 ka ulje prej 21,62% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2011 ka ulje prej 37,93% (për qind) në krahasim me vitin 2010 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2012 ka ulje prej 44% (për qind) në krahasim me vitin 2011 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 113 “Prostitucioni” i Kodit Penal.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprën penale në vitin 2012, rezultoni nga të dhënat statistikore se në prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë janë regjistruar 4 procedime penale për këtë veprën penale, 3 procedime penale janë regjistruar në prokurorinë e rrethit gjyqësor Shkodër, 2 procedime penale në prokurorinë e rrethit gjyqësor Durrës dhe 1 procedim penale në Berat.


### TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 114 i Kodit Penal “Shfrytëzimi i prostitucionit”, në vitin 2012, prej 36,66 % (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Pesha specifike që zë kjo veprën penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit” është 23,17 % (për qind) për vitin 2012, ndërkohë që në vitin 2011 ka qenë 27,77% (për qind).

Ecuria e kësaj veprën penale në pesë vite, 2008-2012 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):

**Neni 114 "Shfrytëzimi i prostitucionit"**



Rezultoni nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 ka ulje prej 23,80% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2010 ka ulje prej 31,25% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2011 ka rritje prej

172,72% (për qind) në krahasim me vitin 2010 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2012 ka ulje prej 36,66% (për qind) në krahasim me vitin 2011 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 114 “Shfrytëzimi i prostitucionit” i Kodit Penal.


Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezulton nga të dhënat statistikore se në prokuroritë e rretheve gjyqësore Berat, Korçë, Përmet, Pogradec, Shkodër është regjistruar nga 1 procedim penal për këtë veprë penale; në Elbasan janë regjistruar 3 procedime penale; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Fier dhe Vlorë janë regjistruar nga 2 procedime penale dhe në prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë janë regjistruar 7 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 114 i Kodit Penal “Shfrytëzimi i prostitucionit”.

### **TENDENCA**

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 114/a i Kodit Penal “Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese”, në vitin 2012, prej 45,45 % (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Kundër moralit dhe dinjitetit” është 21,95 % (për qind) për vitin 2012, ndërkohë që në vitin 2011 ka qenë 30,55% (për qind).

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2008-2012 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 ka ulje prej 48,64% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2010 ka rritje prej 115,78% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2011 ka ulje prej



19,51% (për qind) në krahasim me vitin 2010 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2012 ka ulje prej 45,45% (për qind) në krahasim me vitin 2011 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 114/a “Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese” i Kodit Penal.


Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezulton nga të dhënat statistikore se në prokuroritë e rretheve gjyqësore Berat, Fier, Lezhë, Shkodër dhe Tiranë është regjistruar nga 1 procedim penal për këtë veprë penale; në prokuroritë e rretheve gjyqësore Kavajë, Korçë dhe Lushnje janë regjistruar nga 2 procedime penale; në Durrës janë regjistruar 3 procedime penale dhe në prokurorinë e rrethit gjyqësor Elbasan janë regjistruar 4 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 114/a I Kodit Penal “Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese” në vitin 2012.

### **TENDENCA**

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 118 i Kodit Penal “Dhunimi i varreve”, në vitin 2012, prej 52,94 % (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Kundër moralit dhe nderit” është 31,70 % (për qind) për vitin 2012, ndërkohë që në vitin 2011 ka qenë 15,74% (për qind).

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2008-2012 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 ka ulje prej 55,55% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2010 ka rritje prej 187,5% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2011 ka ulje prej

## Raport i Prokurorit të Përgjithshëmmbi Gjendjen e Kriminalitetit

Për vitin 2012

26,08 % (për qind) në krahasim me vitin 2010 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2012 ka rritje prej 52,94% (për qind) në krahasim me vitin 2011 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 118 “Dhunimi i varreve” i Kodit Penal.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprën penale, rezulton nga të dhënat statistikore se në prokuroritë e rretheve gjyqësore Berat, Fier, Gjirokastrë, Kavajë, Korçë, Krujë, Lezhë, Sarandë, Shkodër dhe tropojë është regjistruar nga 1 procedim penal gjatë vitit 2012; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Vlorë janë regjistruar 2 procedime penale; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë, janë regjistruar 3 procedime penale dhe në prokurorinë e rrethit gjyqësor Elbasan janë regjistruar 11 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 118 i Kodit Penal “Dhunimi i varreve”.

### SEKSIONI IX VEPRA PENALE KUNDËR FËMIJËVE, MARTESËS DHE FAMILJES

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2012 është 1,68% (për qind) dhe në vitin 2011 ishte 0,19% (për qind).

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e IX-të të Kreut të Dytë të Kodit Penal “Vepra Penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes”.

| VEPRA PENALE KUNDËR FËMIJËVE,<br>MARTESËS DHE FAMILJES                          | 2011             |                       |                     |                       |                  | 2012             |                       |                     |                     |                  |
|---|------------------|-----------------------|---------------------|-----------------------|------------------|------------------|-----------------------|---------------------|---------------------|------------------|
|   | Nr. Proc ed Regj | Nr. proced per gjykim | Nr. i pan d. Reg j. | Nr. Pand . Per gjykim | Nr. Pand denu ar | Nr. Proc ed Regj | Nr. proced per gjykim | Nr. i pan d. Reg j. | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denu ar |
| Neni 124 Braktisja e fëmijëve të mitur  | 14               | 7                     | 9                   | 7                     | 3                | 19               | 5                     | 9                   | 5                   | 4                |
| Neni 124/b Keqtrajtimi i të miturit   | 6                | 3                     | 5                   | 3                     | 3                | 4                | 3                     | 4                   | 3                   | 0                |
| Neni 125 Mosdhënia e mjeteve për jetesë   | 0                | 0                     | 0                   | 0                     | 4                | 0                | 0                     | 0                   | 0                   | 3                |
| Neni 126 Mosnjoftimi i ndryshimit të vendbanimit                                | 3                | 2                     | 2                   | 2                     | 1                | 6                | 2                     | 3                   | 2                   | 2                |
| Neni 127 Marrja er padrejtë e fëmijës   | 5                | 2                     | 2                   | 2                     | 0                | 5                | 0                     | 0                   | 0                   | 2                |
| Neni 128 Ndërrimi I fëmijëve  | 0                | 0                     | 0                   | 0                     | 0                | 1                | 0                     | 0                   | 0                   | 0                |
| Neni 128/a Fshehja ose ndërrimi me dashje I fëmijës                             | 1                | 0                     | 0                   | 0                     | 0                | 0                | 0                     | 0                   | 0                   | 0                |
| Neni 129 Shtytja e të miturve në krim   | 6                | 3                     | 5                   | 4                     | 2                | 3                | 0                     | 1                   | 0                   | 0                |
| Neni 130 Shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë | 4                | 0                     | 1                   | 0                     | 0                | 5                | 3                     | 4                   | 3                   | 3                |
| Neni 130/a "Dhuna në familje"   | 0                | 0                     | 0                   | 0                     | 0                | 328              | 159                   | 255                 | 171                 | 69               |
| <b>Totali</b>   | <b>39</b>        | <b>17</b>             | <b>24</b>           | <b>18</b>             | <b>13</b>        | <b>371</b>       | <b>172</b>            | <b>276</b>          | <b>184</b>          | <b>83</b>        |

### TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2012 në total janë 285 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2011 në total kanë qenë 30 të pandehur në hetim.

Nga të pandehurit, asnjë i pandehur i mitur mashkull dhe 1 femër; të pandehur të rritur (mbi 18 vjec) 16 femra, përkundrejt 6 të tilla në vitin 2011 dhe 176 meshkuj të pandehur në vitin 2012, përkundrejt 10 të tillë në vitin 2011 .

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 139 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 50 me arsim të mesëm dhe asnjë i pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror nuk është regjistruar asnjë i pandehur.

Nga sektori privat janë rregjistruar 42 të pandehur përkundrejt 1 të tillë në vitin 2011 dhe të papunë 105 të pandehur, përkundrejt 15 të tillë në vitin 2011.

Rezulton se 86 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 107 të pandehur në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat rurale.

Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 182 të pandehur, vetëm 7 prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme dhe 2 të pandehur janë përsëritës për të njëjtën vepër penale.


## **TENDENCA**

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të rregjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 124 i Kodit Penal “Braktisja e fëmijëve të mitur”, në vitin 2012, prej 35,71 % (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” është 44,18 % (për qind) për vitin 2012, ndërkohë që në vitin 2011 ka qenë 35,89% (për qind).

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2008-2012 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë):

**Neni 124 "Braktisja e fëmijëve të mitur"**



Rezultoni nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 ka ulje prej 6,25% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2010 ka rritje prej 33,33% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2011 ka ulje prej 30% (për qind) në krahasim me vitin 2010 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2012 ka rritje prej 35,71% (për qind) në krahasim me vitin 2011 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 124 “Braktisja e fëmijëve të mitur” i Kodit Penal.


Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale, rezultoni nga të dhënat statistikore se në prokuroritë e rretheve gjyqësore Berat, Korcë, Krujë, Kurbin, Lushnje, Shkodër, dhe Vlorë është regjistruar nga 1 procedim penal për klëtë veprë penale; në prokuroritë e rretheve gjyqësore Durrës, Përmet dhe Tiranë janë regjistruar nga 2 procedime penale dhe në prokuroritë e rretheve gjyqësore Elbasan dhe Fier janë regjistruar nga 3 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 124 i Kodit Penal “Braktisja e fëmijëve të mitur” gjate vitit 2012.

## **TENDENCA**


Në këtë grup veprash penale vihet re se në vitin 2012 janë regjistruar 328 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal “Dhuna në Familje”. Janë dërguar për gjykim 159 procedime penale nga ana e orgganit të prokurorisë në vitin 2012; janë regjistruar 255 të pandehur dhe është ngritur akuza në gjykatë për 171 të pandehur; janë dënuar nga gjykata 69 të pandehur për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal “Dhuna në Familje”.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a I Kodit Penal “Dhuna në familje” për vitin 2012:

**Neni 130/a "Dhuna në familje"**



Grafiku i mëposhtëm paraqet numrin e procedimeve të regjistruara sipas prokurorive të rretheve gjyqësore në vitin 2012, për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal “Dhuna në familje”.



**SEKSIONI X  
LIRIA E BESIMIT**

Në seksionin e X-të të Kreut të Dytë të Kodit Penal janë të parashikuara veprat penale kundër lirisë së besimit, neni 131-133.

VEPRA PENALE KUNDËR  
LIRISË SË BESIMIT

2011

2012



## **Raport i Prokurorit të Përgjithshëmmbi Gjendjen e Kriminalitetit**

**Për vitin 2012**

|  | Nr. Procd . Regj | Nr. proced per gjykim | Nr. i pand . Regj | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Proc d Regj | Nr. proced per gjykim | Nr. i pand . Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar |
|--|------------------|-----------------------|-------------------|----------------------|-----------------|-----------------|-----------------------|-------------------|---------------------|-----------------|
| Neni 131 Pengimi i veprimtarive te organizatave fetare | 0                | 0                     | 0                 | 0                    | 0               | 1               | 0                     | 1                 | 0                   | 0               |
| Neni 132 Shkatërrimi ose demtimi I objekteve te kultit | 1                | 0                     | 1                 | 0                    | 0               | 3               | 1                     | 2                 | 1                   | 1               |
| Neni 133 Pengimi i ceremonive fetare                   | 0                | 0                     | 0                 | 0                    | 0               | 0               | 0                     | 0                 | 0                   | 0               |
| <b>Totali</b>  | <b>1</b>         | <b>0</b>              | <b>1</b>          | <b>0</b>             | <b>0</b>        | <b>4</b>        | <b>1</b>              | <b>3</b>          | <b>1</b>            | <b>1</b>        |

Për këtë grup veprash penale rezultojnë nga të dhënat statistikore si më poshtë: në total 4 procedime penale të regjistruara, nga të cilat 3 procedime penale janë regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 132 i Kodit Penal “Shkatërrimi ose demtimi i objekteve të kultit” dhe një procedim penal është regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 131 I Kodit Penal “Pengimi i veprimtarive të organizatave fetare”; janë regjistruar 3 të pandehur; është dërguar për gjykim një procedim penale dhe është ngritur akuza në gjykatë për një të pandehur; rezulton një i dënuar nga gjykata.

### **KREU III VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË DHE NË SFERËN EKONOMIKE SEKSIONI I, “VJEDHJA E PASURISË”**

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2012 është 42,03 % (për qind), për vitin 2011 40,63 % (për qind) përkundrejt numrit total të procedimeve penale të rregjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2012 në krahasim me vitin 2011.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e parë të Kreut të tretë të Kodit Penal Vjedhja e Pasurisë.

| VJEDHJA E PASURISË  | 2011           |                       |                   |                     |                 | 2012            |                       |                   |                     |                 |
|---|----------------|-----------------------|-------------------|---------------------|-----------------|-----------------|-----------------------|-------------------|---------------------|-----------------|
|   | Nr. Procd Regj | Nr. proced per gjykim | Nr. i pand . Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Proc d Regj | Nr. proced per gjykim | Nr. i pand . Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 134 Vjedhja  | 6798           | 1456                  | 2096              | 2033                | 1820            | 8377            | 1593                  | 2514              | 2387                | 2129            |
| Neni 135 Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën               | 74             | 34                    | 63                | 61                  | 51              | 110             | 29                    | 56                | 47                  | 47              |
| Neni 136 Vjedhja e bankave dhe e arkave të kursim.              | 7              | 6                     | 8                 | 11                  | 10              | 3               | 1                     | 0                 | 2                   | 4               |
| Neni 137 Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike | 795            | 385                   | 363               | 387                 | 442             | 354             | 162                   | 134               | 162                 | 170             |
| Neni 138 Vjedhja e veprave të artit e kulturës                  | 4              | 0                     | 0                 | 0                   | 0               | 2               | 0                     | 0                 | 0                   | 0               |
| Neni 139 Vjedhja me dhunë                                       | 214            | 53                    | 116               | 33                  | 76              | 280             | 80                    | 165               | 149                 | 119             |
| Neni 140 Vjedhja me armë  | 106            | 23                    | 58                | 48                  | 34              | 131             | 24                    | 68                | 53                  | 44              |
| Neni 141 Vjedhja me pasojë vdekjen                              | 105            | 5                     | 4                 | 13                  | 9               | 20              | 4                     | 3                 | 6                   | 7               |
| Neni 142 Sigurimi i mjeteve për vjedhje                         | 5              | 6                     | 5                 | 8                   | 4               | 3               | 2                     | 4                 | 4                   | 6               |
| <b>Totali</b>   | <b>8015</b>    | <b>1968</b>           | <b>2713</b>       | <b>2594</b>         | <b>2446</b>     | <b>9280</b>     | <b>1895</b>           | <b>2944</b>       | <b>2810</b>         | <b>2526</b>     |

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2012 ka një rritje prej 15,78 % (për qind) të numrit të procedimeve të rregjistruara për Vjedhja e pasurisë në krahasim me vitin 2011. Ndërkaq kemi ulje prej 3,7 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2011. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2011 prej 8,51 % (për qind); një rritje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 8,32 % (për qind) dhe kemi rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 3,27 % (për qind) përkundrejt vitit 2011.

## **TE PANDEHURIT**

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2012 në total janë 3655 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2011 në total kanë qenë 3409 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re rritje prej 7,21% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2012 në krahasim me vitin 2011. Në vitin 2012 vihet re një rritje e të pandehurve për të cilët është ngritur akuza në gjykatë prej 6,05% në krahasim me vitin 2011.

Nga të pandehurit, 811 kanë qenë të pandehur të mitur meshkuj (rritje prej 27,31% e këtij treguesi në krahasim me vitin 2011) dhe 2 femra; të pandehur të rritur (mbi 18 vjec) 52 femra dhe 2355 meshkuj (rritje prej 9,07% e këtij treguesi për vitin 2011).

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 2118 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 818 me arsim të mesëm dhe 47 të pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj veprash penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë rregjistruar 130 të pandehur përkundrejt 33 të tillë në vitin 2011. Nga këta, 10 të pandehur janë funksionarë, 108 të pandehur janë nëpunës i thjeshtë, 2 nëpunës janë të niveit të lartë, 3 nëpunës të nivelit të ulët dhe 7 nëpunës të nivelit ekzekutues.

Nga sektori privat janë rregjistruar 453 të pandehur (rritje prej 18,58% për qind) në krahasim me vitin 2011 dhe të papunë 2079 (rritje prej 35,61% (për qind) në krahasim me vitin 2011. Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj veprash penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Rezulton se 1475 të pandehur kanë vendbanimin në qytet \*ulje prej 14,29% në krahasim me vitin 2011) ndërsa 1470 prej tyre në komuna (rritje prej 30,55% në krahasim me vitin 2011). Pra tendenca është e tillë fenomeni është njësoj i pranishëm sin ë zonat urbane ashtu edhe në zonat rurale.

Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 2536 të pandehur, 350 prej tyre janë përsëritës për të


njëjtën vepër penale (rritje prej 73, 26% në krahasim me vitin 2011), ndërsa 189 të pandehur janë përsëritës për vepra penale të ndryshme (rritje prej 35,97% në krahasim me vitin 2011).

## TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal “Vjedhja”, në vitin 2012, prej 23,22 % (për qind) në krahasim me vitin 2011.


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike” është 90,26% % (për qind) për vitin 2012, ndërkohë që në vitin 2011 ka qenë 84,81% (për qind).

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2008-2012 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 ka rritje prej 20,76% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2010 ka rritje prej 23,95% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2011 ka rritje prej 4,19% (për qind) në krahasim me vitin 2010 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2012 ka rritje prej 23,22% (për qind) në krahasim me vitin 2011 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 134 “Vjedhja” i Kodit Penal.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara sipas prokurorive të rrethëve gjyqësore, nga të dhënat statistikore rezulton se:



**Neni 134 "Vjedhja"**



Rezultoni nga të dhënat statistikore se në prokuroritë e rretheve gjyqësore më poshtë ka patur rritje të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale në vitin 2012 në krahasim me vitin 2011:

Berat, rritje prej 33,75% të procedimeve penale të regjistruara, në krahasim me vitin 2011; Durrës rritje prej 22,32% të procedimeve penale të regjistruara, në krahasim me vitin 2011; Elbasan, rritje prej 22,15% të procedimeve penale të regjistruara, në krahasim me vitin 2011; Fier, rritje prej 55,55% të procedimeve penale të regjistruara, në krahasim me vitin 2011; Gjirokastër, rritje prej 26,38% të procedimeve penale të regjistruara, në krahasim me vitin 2011; Kavajë, rritje prej 4,54% të procedimeve penale të regjistruara, në krahasim me vitin 2011; Korçë, rritje prej 18,96% të procedimeve penale të regjistruara, në krahasim me vitin 2011; Krujë, rritje prej 105,60% të procedimeve penale të regjistruara, në krahasim me vitin 2011; Kukës, rritje prej 58,46% të procedimeve penale të regjistruara, në krahasim me vitin 2011; Lezhë, rritje prej 29,90% të procedimeve penale të regjistruara, në krahasim me vitin 2011; Përmet, rritje prej 57,14% të procedimeve penale të regjistruara, në krahasim me vitin 2011; Pogradec, rritje prej 35,41% të procedimeve penale të regjistruara, në krahasim me vitin 2011; Pukë, rritje prej 30,55% të procedimeve penale të regjistruara, në krahasim me vitin 2011; Sarandë, rritje prej 7,69% të procedimeve penale të regjistruara, në krahasim me vitin 2011; Shkodër, rritje prej 18,50% të procedimeve penale të regjistruara, në krahasim me vitin 2011; Tiranë, rritje prej 27,63% të procedimeve penale të regjistruara, në krahasim me vitin 2011; Tropojë, rritje prej 21,73% të procedimeve penale të regjistruara, në krahasim me vitin 2011; Vlorë, rritje prej 7,13% të procedimeve penale të regjistruara, në krahasim me vitin 2011;

Rezulton nga të dhënat statistikore se në prokuroritë e rretheve gjyqësore më poshtë ka patur ulje të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale në vitin 2012 në krahasim me vitin 2011:


Dibër, ulje prej 13,08% të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2011  
Elbasan, ulje prej 22,15% të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2011;  
Kurbini, ulje prej 2,06% të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2011;  
Lushnje, ulje prej 9,24% të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2011; Mat,  
ulje prej 5,97% e procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2011.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me procedimet penale të regjistruara për këtë vepër penale në vitet 2011 dhe 2012:



**Raport i Prokurorit të Përgjithshëm Gjendjen e Kriminalitetit**

**Për vitin 2012**




## TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal “Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën”, në vitin 2012, prej 48,64 % (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vjedhja e pasurisë” është 1,18 % (për qind) për vitin 2012, ndërkohë që në vitin 2011 ka qenë 0,92% (për qind).


Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2008-2012 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 ka ulje prej 25,31% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2010 ka rritje prej 30,50% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2011 ka ulje prej 3,89% (për qind) në krahasim me vitin 2010 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2012 ka rritje prej 48,64% (për qind) në krahasim me vitin 2011 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 135 “Vjedhja duke shpërdoruar detyrën” i Kodit Penal.

Grafiku mëposhtëm paraqet të dhëna në përqindje në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2012 për veprën penale të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal “Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën”

**Neni 135 "Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën"**



Duke krahasuar procedimet penale të regjistruara për këtë veprë penale në vitet 2011-2012, rezultojnë nga të dhënat statistikore se në prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë ka një rritje të ndjeshme të procedimeve të regjistruara në vitin 2012 në krahasim me vitin 2011. Kështu në vitin 2012 janë regjistruar 43 procedime penale ndërsa në vitin 2011 janë regjistruar 22 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 135 I Kodit Penal “Vjedhja duke shpërdoruar detyrën”; në Elbasan janë regjistruar 8 procedime penale në vitin 2012, përkundërsht vitit 2011 kur janë regjistruar 4 procedime penale; në Kavajë janë regjistruar 4 procedime penale në vitin 2012, ndërkohë në vitin 2011 nuk ishte regjistruar asnjë procedim penal; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Shkodër, janë regjistruar 9 procedime penale në vitin 2012, ndërkohë në vitin 2011 janë regjistruar 13 procedime penale; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Vlora janë regjistruar 12 procedime penale në vitin 2012, ndërsa në vitin 2011 janë regjistruar 7 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 135 I Kodit Penal “Vjedhja duke shpërdoruar detyrën”.


### **TENDENCA**

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 137 i Kodit Penal “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulsive telefonike”, në vitin 2012, prej 55,47 % (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Vjedhja e pasurisë” është 3,81% (për qind) për vitin 2012, ndërkohë që në vitin 2011 ka qenë 9,91% (për qind).

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2008-2012 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):

**Neni 137 "Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike"**




Rezultoni nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 ka ulje prej 69,88% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2010 ka rritje prej 672,64% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2011 ka ulje prej 2,93% (për qind) në krahasim me vitin 2010 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2012 ka ulje prej 55,47% (për qind) në krahasim me vitin 2011 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 137 "Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike" i Kodit Penal.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale, rezultoni nga të dhënat statistikore se në prokuroritë e rretheve gjyqësore Korçë dhe Lushnje janë regjistruar nga 1 procedim penal në vitin 2012; në prokuroritë e rretheve gjyqësore Kavajë dhe Lezhë janë regjistruar nga 2 procedime penale gjatë vitit 2012; në Kurbin janë regjistruar 3 procedime penale; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Dibër janë regjistruar 7 procedime penale; në fier janë regjistruar 9 procedime penale; në prokuroritë e rretheve gjyqësore Krujë dhe Vlora janë regjistruar nga 10 procedime penale; në elbasan janë regjistruar 15 procedime penale; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Durrës janë regjistruar 30 procedime penale; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Mat janë regjistruar 51 procedime penale; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Shkodër janë regjistruar 90 procedime penale dhe në prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë janë regjistruar 123 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 137 I Kodit Penal "Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike" gjatë vitit 2012.

Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale sipas prokurorive të rretheve gjyqësore, në përqindje.

**Neni 137 "Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike"**




**TENDENCA**

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të rregjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal "Vjedhja me dhunë", në vitin 2012, prej 30,84 % (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Vjedhja e pasurisë" është 3,017 % (për qind) për vitin 2012, ndërkohë që në vitin 2011 ka qenë 2,66% (për qind).

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2008-2012 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë):


**Neni 139 "Vjedhja me dhunë"**



Rezultoni nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 ka rritje prej 4,80% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2010 ka rritje prej 23,85% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2011 ka rritje prej 58,51% (për qind) në krahasim me vitin 2010 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2012 ka rritje prej 30,84% (për qind) në krahasim me vitin 2011 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 139 “Vjedhja me dhunë” i Kodit Penal.

Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale gjatë vitit 2012 sipas prokurorive të rretheve gjyqësore, në përqindje:

**Neni 139 "Vjedhja me dhunë"**






Në prokurorinë e rrethit gjyqësor Berat në vitin 2012 janë regjistruar 4 procedime penale, përkundëjt vitit 2011 kur janë regjistruar 3 procedime penale; në Dibër, janë regjistruar gjatë vitit 2012 3 procedime penale, në vitin 2011 është regjistruar 1 procedim penal; në Durrës janë regjistruar 35 procedime penale që do të thotë rritje prej 84,21% në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Elbasan janë regjistruar 19 procedime penale, përkundëjt 5 procedimeve të regjistruara në vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Fier janë regjistruar 19 procedime penale, që do të thotë rritje prej 35,71% në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Gjirokastrë janë regjistruar 4 procedime penale, përkundëjt vitit 2011 kur është regjistruar vetëm 1 procedim penal; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Kavajë janë regjistruar 2 procedime penale, përkundëjt 3 procedimeve të regjistruara në vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Korçë janë regjistruar 9 procedime penale, përkundëjt 8 procedimeve të regjistruara në vitin 2011; në Krijë janë regjistruar 3 procedime penale në vitin 2012, përkundëjt 4 procedimeve penale të regjistruara në vitin 2011; në Kukës, në vitet 2011 dhe 2012 janë regjistruar nga 2 procedime penale; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Kurbin, janë regjistruar 7 procedime penale në vitin 2012, përkundëjt vitit 2011 kur janë regjistruar 9 procedime penale; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Lezhë janë regjistruar 6 procedime penale, përkundëjt 9 procedimeve penale të regjistruara në vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Lushnjë është regjistruar 1 procedim penal, që do të thotë ulje prej 90% në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Përmet janë regjistruar 2 procedime penale; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Pogradec janë regjistruar 8 procedime penale, që do të thotë rritje prej 100% në krahasim me vitin 2011; në Pukë, në vitin 2012 dhe 2011 është regjistruar nga 1 procedim penal; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Sarandë janë regjistruar 5 procedime penale në vitin 2012, përkundëjt 6 procedimeve të regjistruara në vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Shkodër janë regjistruar 16 procedime penale, që do të thotë rritje prej 128,57% në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë janë regjistruar 106 procedime penale, që do të thotë rritje prej 34,17% në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Vlorë janë regjistruar 28 procedime penale, përkundëjt 26 procedimeve penale të regjistruara në vitin 2011, për veprën penale të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal “Vjedhja me dhunë”.

## **TENDENCA**

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të rregjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 140 i Kodit Penal “Vjedhja me armë”, në vitin 2012, prej 23,58% (për qind) në krahasim me vitin 2011.


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vjedhja e pasurisë” është 1,41 % (për qind) për vitin 2012, ndërkohë që në vitin 2011 ka qenë 1,32% (për qind).

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2008-2012 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë):




Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 ka rritje prej 35,48% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2010 ka rritje prej 50% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2011 ka ulje prej 15,87% (për qind) në krahasim me vitin 2010 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2012 ka rritje prej 23,58% (për qind) në krahasim me vitin 2011 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 140 "Vjedhja me armë" i Kodit Penal.

Grafiku i mëposhtën paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për këtë veprë penale:



Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me procedimet penale të regjistruara për këtë vepër penale sipas prokurorive të rretheve gjyqësore në vitet 2011-2012:

Rezulton se në Berat janë regjistruar 2 procedime penale në vitin 2012; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Dibër është regjistruar nga 1 procedim penal në vitet 2011 dhe 2012; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Durrës janë regjistruar 9 procedime penale në vitin 2012, që do të thotë ulje prej 30,76% në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Elbasan janë regjistruar 9 procedime penale që do të thotë rritje prej 50% në krahasim me vitin 2011; në Fier janë regjistruar 10 procedime penale, përkundëjt 4 procedimeve penale të regjistruara në vitin 2011; në prokuroritë e rretheve gjyqësore Gjirokastrë, Kavajë, Korçë, Krujë, Kurbin, Lezhë dhe Lushnjë janë regjistruar nga 3 procedime penale në vitin 2012; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Kukës janë regjistruar 6 procedime penale, përkundëjt asnjë procedimi penal të regjistruar në vitin 2011; në prokuroritë e rretheve gjyqësore Mat dhe Sarandë janë regjistruar nga 2 procedime penale në vitin 2012; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Shkodër janë regjistruar 10 procedime penale, që do të thotë rritje prej 25% në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë janë regjistruar 44 procedime penale, që do të thotë rritje prej 69,23% e procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2011, për veprën penale të parashikuar nga neni 140 I Kodit Penal, "Vjedhja me armë".




**TENDENCA**

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal “Vjedhja me pasojë vdekjen”, në vitin 2012, prej 80,95 % (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vjedhja e pasurisë” është 0,21 % (për qind) për vitin 2012, ndërkohë që në vitin 2011 ka qenë 1,31% (për qind).

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2008-2012 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):

**Neni 141 "Vjedhja me pasojë vdekjen"**



Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 ka ulje prej 28,57% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2010 ka rritje prej 20% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2011 ka rritje të theksuar prej 105 procedimesh penale përkundrejt 6 procedimeve të regjistruara në vitin 2010 dhe në vitin 2012 ka ulje prej 80,95% (për qind) në krahasim me vitin 2011 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 141 “Vjedhja me pasojë vdekjen” i Kodit Penal.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale, rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2012 janë regjistruar 16 procedime penale në Dibër dhe 4 procedime penale në Tiranë, përkundrejt 94 procedimeve penale të regjistruara në Tiranë në vitin 2011.

### **KREU III**

#### **SEKSIONI II, MASHTRIMET**

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2012 është 2,44 % (për qind), për vitin 2011 3,43 % (për qind) përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2012 në krahasim me vitin 2011.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Skesionin e II, të Kreut të Tretë të Kodit Penal “Mashtrimet”

## **Raport i Prokurorit të Përgjithshëmmbi Gjendjen e Kriminalitetit**

**Për vitin 2012**

| MASHTRIMET   | 2011             |                        |                     |                       |                  | 2012             |                        |                     |                     |                  |
|--|------------------|------------------------|---------------------|-----------------------|------------------|------------------|------------------------|---------------------|---------------------|------------------|
|  | Nr. Proc ed Regj | Nr. proc ed per gjykim | Nr. i pan d. Reg j. | Nr. Pand . Per gjykim | Nr. Pand denu ar | Nr. Proc ed Regj | Nr. proc ed per gjykim | Nr. i pan d. Reg j. | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denu ar |
| Neni 143 Mashtrimi   | 658              | 396                    | 454                 | 441                   | 349              | 472              | 328                    | 216                 | 339                 | 428              |
| Neni 143/a Skemat mashtruese dhe piramidale  | 2                | 0                      | 1                   | 0                     | 0                |                  |                        |                     |                     |                  |
| Neni 143/a/1 Manipulimi i tregut   |                  |                        |                     |                       |                  | 0                | 0                      | 0                   | 0                   | 0                |
| Neni 143/a/2 Përdorimi i paautorizuar dhe përhapja e informacionit të privilegjuar |                  |                        |                     |                       |                  |                  |                        |                     |                     |                  |
| Neni 143/a/3 Manipulimi i cmimeve dhe përhapja e informacionit të rremë            |                  |                        |                     |                       |                  |                  |                        |                     |                     |                  |
| Neni 143/a/4 Paraqitja e të dhënave të rreme dhe shpërndarja e paautorizuar e tyre |                  |                        |                     |                       |                  |                  |                        |                     |                     |                  |
| Neni 143/a/5 Regjistrimi i titujve në bursë në mënyrë të paautorizuar              |                  |                        |                     |                       |                  |                  |                        |                     |                     |                  |
| Neni 143/a/6 Fshehja e pronësisë   |                  |                        |                     |                       |                  |                  |                        |                     |                     |                  |
| Neni 143/a/7 Tregtimi i paligjshëm i titujve                                       |                  |                        |                     |                       |                  |                  |                        |                     |                     |                  |
| Neni 144 Mashtrimi në subvencione  | 2                | 1                      | 1                   | 1                     | 2                | 0                | 0                      | 0                   | 0                   | 7                |
| Neni 145 Mashtrimi në sigurime   | 7                | 2                      | 4                   | 6                     | 3                | 50               | 23                     | 46                  | 25                  | 22               |
| Neni 146 Mashtrimi në kredi  | 7                | 5                      | 7                   | 14                    | 4                | 9                | 5                      | 6                   | 8                   | 10               |
| Neni 147 Mashtrimi për veprat e artit e të kulturës                                | 0                | 1                      | 0                   | 3                     | 3                | 1                | 0                      | 0                   | 0                   | 0                |
| Neni 148 Botimi i veprës së tjetrit me emrin e vet                                 | 0                | 0                      | 0                   | 0                     | 0                | 0                | 0                      | 0                   | 0                   | 0                |
| Neni 149 Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit                               | 2                | 0                      | 0                   | 0                     | 0                | 0                | 0                      | 0                   | 0                   | 0                |
| Neni 149/a Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale                          |                  |                        |                     |                       |                  | 6                | 1                      | 10                  | 1                   | 0                |
| Neni 149/b Shkelja e të drejtave të topografisë së qarkut të gjysmëpërcuesit       |                  |                        |                     |                       |                  | 1                | 0                      | 0                   | 0                   | 0                |

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2012 ka një ulje prej 20,50% (për qind) të numrit të procedimeve të rregjistruara për “mashtyrim,et” në krahasim me vitin 2011. Ndërkaq kemi ulje prej 11,85 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2011. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të rregjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2011 prej 40,47 % (për qind); një ulje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 19,78 % (për qind) dhe kemi rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 29,36 % (për qind) përkundrejt vitit 2011.

### **TË PANDEHURIT**

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2012 në total janë 487 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2011 në total kanë qenë 631 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re ulje prej 22,82% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2012 në krahasim me vitin 2011.



Nga të pandehurit, 1 ka qenë i pandehur i mitur mashkull; të pandehur të rritur (mbi 18 vjec) 32 femra dhe 391 meshkuj.

Rezultojnë 2 shteta të huaj të pandehur në vitin 2012, përkundrajt 4 të tilla në vitin 2011.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 259 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 140 me arsim të mesëm dhe 35 të pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë rregjistruar 5 të pandehur përkundrajt 8 të pandehur nga sektori shtetëror në vitin 2011. 5 të pandehurit janë nëpunës i thjeshtë.

Nga sektori privat janë rregjistruar 145 të pandehur (ulje prej 40,32% për qind) në krahasim me vitin 2011 dhe të papunë 142 (rritje prej 75,30% (për qind) në krahasim me vitin 2011. Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Rezulton se 277 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 51 prej tyre në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.


Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 321 të pandehur, vetëm 2 prej tyre janë përsëritës për të njëjtën vepër penale, ndërsa 5 të pandehur janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

## **TENDENCA**

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të rregjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal “Mashtrimi”, në vitin 2012, prej 28,26 % (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Mashtrimet” është 87,56 % (për qind) për vitin 2012, ndërkohë që në vitin 2011 ka qenë 97,05% (për qind).

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2008-2012 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë):




Rezultoni nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 ka rritje prej 22,58% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2010 ka ulje prej 17,71% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2011 ka rritje prej 43,04% (për qind) në krahasim me vitin 2010 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2012 ka ulje prej 28,26% (për qind) në krahasim me vitin 2011 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 143 “Mashtrimi” i Kodit Penal.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal “Mashtrimi”, gjatë vitit 2012. Në rubrikën “të tjerë janë përfshirë rrethe që kanë regjistruar deri në 3 procedime penale për këtë veprë penale. Kështu, prokuroritë e rretheve gjyqësore Lezhë dhe Tropojë kanë regjistruar nga 1 procedim penal në vitin 2012; prokuroria e rrethit gjyqësor Kavajë dhe Pukë kanë regjistruar nga 2 procedime penale dhe prokuroria e rrethit gjyqësor Kurbin ka regjistruar 3 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal “Mashtrimi”.

Me ulje të theksuar të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale rrezultoni prokuroria e rrethit gjyqësor Berat, me 90 procedime penale të regjistruara në vitin 2012, përkundërt 288 të tilla në vitin 2011 (ulje prej 68,75% në krahasim me vitin 2011); në prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë në vitin 2012 janë regjistruar 174 procedime penale, përkundërt vitit 2011 kur janë regjistruar 191 procedime penale (që do të thotë ulje prej 8,9% në krahasim me vitin 2011);

**Neni 143 "Mashtrimi"**




## TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të rregjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal “Mashtrimi në sigurime”, në vitin 2012, janë regjistruar 50 procedime penale për këtë veprë penale, përkundrejt vitit 2011 kur janë regjistruar 7 procedime penale.

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Mashtrimet” është 9,27 % (për qind) për vitin 2012, ndërkohë që në vitin 2011 ka qenë 1,03% (për qind).

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2008-2012 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë); rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 ka rritje prej 70,58% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të rregjistruara; në vitin 2010 ka ulje prej 86% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të rregjistruara; në vitin 2011 ka ulje prej 12,5% (për qind) në krahasim me vitin 2010 të procedimeve penale të rregjistruara dhe në vitin 2012 ka rritje më 50 procedime penale, në krahasim me vitin 2011 kur janë regjistruar 7 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 145 “Mashtrimi në sigurime” i Kodit Penal.

**Neni 145 "Mashtrimi në sigurime"**



Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara në vitin 2012, rezulton se në prokurorinë e rrethit gjyqësor Berat janë regjistruar 9 procedime penale; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Durrës janë regjistruar 8 procedime penale; në prokuroritë e rretheve gjyqësore Elbasan, Korçë dhe Tiranë janë regjistruar nga 2 procedime penale; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Kukës janë regjistruar 18 procedime penale; në pogradec janë regjistruar 3 procedime penale; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Sarandë është regjistruar 1 procedim penal; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Shkodër janë regjistruar 4 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal “Mashtrimi në sigurime”.

**KREU III  
SEKSIONI III SHKATËRRIMI I PRONËS**

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2012 është 4,58 % (për qind), për vitin 2011, 4,77 % (për qind) përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2012 në krahasim me vitin 2011.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e III, të Kreut të III të Kodit Penal .

| SHKATËRRIMI I<br>PRONËS                | 2011            |                      |                   |                     |                 | 2012              |                    |                      |                 |    |
|--|-----------------|----------------------|-------------------|---------------------|-----------------|-------------------|--------------------|----------------------|-----------------|----|
|  | Nr. Proc d Regj | Nr. procd per gjykim | Nr. i pand . Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Proc d . Regj | Nr. i pand . Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar |    |
në prokurorinë e rrethit gjyqësor Berat janë regjistruar 14 procedime penale në vitin 2012, që do të thotë rritje prej 250% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Durrës janë regjistruar 33 procedime penale në vitin 2012, që do të thotë ulje prej 49,23% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Elbasan janë regjistruar 32 procedime penale në vitin 2012, që do të thotë ulje prej 3,03% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Fier janë regjistruar 35 procedime penale në vitin 2012, që do të thotë rritje prej 118,75% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Gjirokastrë janë regjistruar 27 procedime penale në vitin 2012, që do të thotë rritje prej 145,45% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Korçë janë regjistruar 17 procedime penale në vitin 2012, që do të thotë ulje prej 37,03% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Krujë janë regjistruar 3 procedime penale në vitin 2012; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Kukës janë regjistruar 24 procedime penale në vitin 2012, që do të thotë ulje prej 4% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Kurbin është regjistruar 1 procedim penale në vitin 2012, që do të thotë ulje prej 75% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Lezhë janë regjistruar nga 11 procedime penale në vitin 2012 dhe në vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Lushnje janë regjistruar 8 procedime penale në vitin 2012, që do të thotë rritje prej 100% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Pogradec janë regjistruar nga 23 procedime penale në vitin 2012 dhe në vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Pukë është regjistruar 1 procedim penal; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Sarandë janë regjistruar 8 procedime penale në vitin 2012, që do të thotë ulje prej 52,94% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Shkodër janë regjistruar 22 procedime penale në vitin 2012, që do të thotë ulje prej 33,33% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë janë regjistruar 44 procedime penale në vitin 2012, që do të thotë ulje prej 52,68% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në prokurorinë e rrethit gjyqësor




## Raport i Prokurorit të Përgjithshëm Gjendjen e Kriminalitetit

Për vitin 2012

tropojë janë regjistruar 4 procedime penale në vitin 2012, përkundrajt 1 procedimi penale të regjistruar në vitin 2011 dhe në prokurorinë e rrethit gjyqësor Vlorë janë regjistruar 36 procedime penale në vitin 2012, që do të thotë rritje prej 28,57% (për qind) në krahasim me vitin 2011, për veprën penale të parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal “Trafikimi i mjeteve motorike”.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:




**TENDENCA**

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 278/a i Kodit Penal “Trafikimi i armëve dhe i municionit”, në vitin 2012, prej 58,33 % (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër trafiqeve të paligjshme” është 3,66 % (për qind) për vitin 2012, ndërkohë që në vitin 2011 ka qenë 2,41% (për qind).

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2008-2012 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Rezultoni nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 ka ulje prej 24,24% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2010 ka rritje prej 20% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2011 ka ulje prej 60% (për qind) në krahasim me vitin 2010 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2012 ka rritje prej 58,33% (për qind) në krahasim me vitin 2011 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 278/a “Trafikimi i armëve dhe i municionit” i Kodit Penal.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale rezultoni nga të dhënat statistikore se në prokurorinë për krime të renda janë regjistruar 18 procedime penale dhe në prokurorinë e rrethit gjyqësor Tropojë është regjistruar 1 procedim penal në vitin 2012 për veprën penale të parashikuar nga e “Trafikimi i armëve dhe i municionit” i Kodit Penal.




## TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal “Trafikimi i narkotikëve”, në vitin 2012, prej 100% (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër trafiqeve të paligjshme” është 27,74 % (për qind) për vitin 2012, ndërkohë që në vitin 2011 ka qenë 14,48% (për qind).

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2008-2012 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):

**Neni 283/a "Trafikimi i narkotikëve"**



Rezultoni nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 ka ulje prej 27,69% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2010 ka ulje prej 2,12% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2011 ka rritje prej 56,52% (për qind) në krahasim me vitin 2010 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2012 ka rritje prej 100% (për qind) në krahasim me vitin 2011 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a “Trafikimi i narkotikëve” i Kodit Penal.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale rezultoni nga të dhënat statistikore se në vitin 2012 janë regjistruar 142 procedime penale pranë Prokurorisë për Krime të Rënda dhe nga 1 procedim penale është regjistruar në prokuroritë e rretheve gjyqësore Korçë dhe Shkodër.

## VEPRA PENALE QË LIDHEN ME KRIMIN E ORGANIZUAR

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me vepra penale kundër krimit të organizuar:

**Raport i Prokurorit të Përgjithshëmmbi Gjendjen e Kriminalitetit**

**Për vitin 2012**

| KRIMI I ORGANIZUAR  | 2011             |                       |                     |                       |                  | 2012             |                       |                    |                     |                  |
|---|------------------|-----------------------|---------------------|-----------------------|------------------|------------------|-----------------------|--------------------|---------------------|------------------|
|   | Nr. Proc d. Regj | Nr. proced per gjykim | Nr. i pan d. Reg j. | Nr. Pand . Per gjykim | Nr. Pand denu ar | Nr. Proc ed Regj | Nr. proced per gjykim | Nr. i pan d. Reg j | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denu ar |
| Neni 333 Organizata kriminale   | 1                | 0                     | 0                   | 0                     | 0                | 1                | 1                     | 1                  | 1                   | 2                |
| Neni 333/a Grupi i strukturuar kriminal   | 3                | 1                     | 0                   | 3                     | 10               | 2                | 1                     | 3                  | 3                   | 11               |
| Neni 334 Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal | 0                | 0                     | 0                   | 0                     | 0                | 0                | 0                     | 0                  | 0                   | 0                |
| <b>Totali</b>   | <b>4</b>         | <b>1</b>              | <b>0</b>            | <b>3</b>              | <b>10</b>        | <b>3</b>         | <b>2</b>              | <b>4</b>           | <b>4</b>            | <b>13</b>        |

Rezultoni nga të dhënat statistikore se për këtë grup veprash penale janë regjistruar 3 procedime penale në vitin 2012 nga të cilat 2 prej tyre janë dërguar për gjykim; janë regjistruar 4 të pandehur dhe është ngritur akuza në gjykatë për 4 të pandehur. Në vitin 2012 janë dënuar nga gjykata 13 të pandehur, përkundrajt 10 të tillë në vitin 2011.

### TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2012 në total janë 11 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2011 në total kanë qenë 6 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re rritje prej 83,33% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2012 në krahasim me vitin 2011.


Nga të pandehurit, 4 kanë qenë të pandehur te rritur (mbi 18 vjec) meshkuj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezultoni se 4 të pandehur janë me arsim të mesëm.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se nga sektori privat janë regjistruar 3 të pandehur 1 i pandehur i papunë.

Rezultoni se 3 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 1 prej tyre në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.

**TË DHËNA PËR TË PANDEHURIT PËR VITIN 2012**



Grafiku i mësipërm paraqet të dhëna për të pandehur në hetim në pesë vitet e fundit (2008 – 2012). Në të dhënat e një viti përfshihen të pandehur të cilët janë mbartur nga viti i kaluar, të pandehur për të cilët është rifilluar hetimi nga organi i prokurorisë, të pandehur të regjistruar nga organi i prokurorisë dhe të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë.

Sikurse shihet nga grafiku i mësipërm, të dhënat tregojnë për një tendencë gjithnjë në rritje të numrit të pandehurve në hetim nga viti në vit dhe me një ulje të lehtë në vitin 2009.

Në lidhje me të pandehurit e regjistruar, nga të dhënat statistikore rezultojnë se dinamika e këtij treguesi në pesë vite është si më poshtë:

Në vitin 2008 janë regjistruar 9548 të pandehur, që do të thotë 5,9% (për qind) më shumë se në vitin 2007; në vitin 2009 janë regjistruar 8130 të pandehur, që do të thotë ulje prej 14,85% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 janë regjistruar 10558 të pandehur që do të thotë rritje prej 29,86% në krahasim me vitin 2009; në vitin 2011 janë regjistruar 10779 të pandehur, që do të thotë rritje prej 2,09% (për qind) në krahasim me vitin 2010 dhe në vitin 2012 janë regjistruar 10798 të pandehur, që do të thotë rritje prej 9% (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Të pandehur të mbartur, nga viti në vit, duke marrë në referencë vitet 2008-2012 rezultojnë se:


Në vitin 2008 janë mbartur 2230 të pandehur, që do të thotë 16,87% (për qind) më shumë se në vitin 2007; në vitin 2009 janë mbartur 2962 të pandehur, që do të thotë rritje prej 32,82% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 janë mbartur 2828 të pandehur që do të thotë ulje prej 4,52% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në vitin 2011 janë mbartur 2879 të pandehur, që do të thotë rritje prej 1,8% (për qind) në krahasim me vitin 2010 dhe në vitin 2012 janë mbartur 3207 të pandehur që do të thotë rritje prej 4% (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Në lidhje me të pandehurit, për të cilët është vendosur rifillimi hetimeve rezulton se:


Në vitin 2008 janë rifilluar hetimet për 136 të pandehur, që do të thotë 42,6% (për qind) më pak se në vitin 2007; në vitin 2009 janë rifilluar hetimet për 152 të pandehur, që do të thotë rritje prej 11,76% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 janë rifilluar hetimet për 156 të pandehur, që do të thotë rritje prej 2,63% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në vitin 2010 janë rifilluar hetimet për 150 të pandehur që do të thotë një ulje e lehtë prej 3,84% (për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe në vitin 2012 janë rifilluar hetimet për 119 të pandehur, që do të thotë ulje 20,66% (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Në vitin 2008 është ngritur akuzë në gjykatë për 8726 të pandehur ose 13% (për qind) më shumë se në vitin 2007; në vitin 2009 është ngritur akuzë në gjykatë për 8352 të pandehur ose 4,28% (për qind) më pak se në vitin 2008 dhe në vitin 2010 është ngritur akuzë në gjykatë për 9261 të pandehur që do të thotë rritje prej 10,88% (për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe në vitin 2010 është ngritur akuzë në gjykatë për 9256 të pandehur që do të thotë një ulje e papërfillshme në krahasim me vitin 2009 prej 0,05% (për qind) dhe në vitin 2012 është ngritur akuzë në gjykatë për 9354 të pandehur ose 3% (për qind) më shumë se në vitin 2011.

Grafiku i mëposhtëm paraqet numrin e të pandehurve për të cilët kanë përfunduar hetimet dhe mënyra e përfundimit të tyre për vitet 2011 dhe 2012:



Më poshtë paraqitet në mënyrë grafike të dhëna mbi të pandehurit për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, të pandehur të dënuar dhe të dënuar, në pesë vitet e fundit (2007-2011):



Në lidhje me të pandehurit të gjykuar në raport me të pandehurit për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, rezulton nga të dhënat statistikore se:

Në vitin 2008, 86% e të pandehurve të dërguar gjyqit janë gjykuar; në vitin 2009, 89,2% e të pandehurve të dërguar gjyqit janë gjykuar dhe në vitin 2010. 87,12% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit janë gjykuar dhe në vitin 2010, nga të dhënat statistikore, rezulton se 96,21% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit janë gjykuar në vitin 2011 dhe në vitin 2012 janë gjykuar 101% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit.

Në lidhje me të pandehurit e dënuar të dhënat rezultojnë si vijon:

Në në vitin 2009 janë dënuar 7172 të pandehur ose 85,87% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit dhe në vitin 2010 janë dënuar 7763 të pandehur ose 83,82% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit; në vitin 2011 janë dënuar 8654 të pandehur ose 93,49% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit dhe në vitin 2012 janë dënuar 8386 të pandehur ose 89,65% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit.



**TREGUESI I EFEKTIVITETIT TË ORGANIT TË PROKURORISË NË VITE, NË GJYKIMIN DHE NË DËNIMIN E TË PANDEHURVE**

rezulton se për vitin 2008 rreth 96,76% (për qind) e personave të gjykuar janë shpallur fajtorë nga gjykata; në vitin 2009 rreth 96,29% (për qind) e personave të gjykuar janë shpallur fajtorë nga gjykata; për vitin 2010 rreth 96,20% (për qind) e personave të gjykuar janë shpallur fajtorë nga gjykata; në vitin 2011 për rreth 96,21% (për qind) e personave të gjykuar janë shpallur fajtorë nga gjykata dhe në vitin 2012 për rreth 88,35% (për qind) e personave të gjykuar janë shpallur fajtorë nga gjykata.

**TREGUESI I EFEKTIVITETIT TË ORGANIT TË PROKURORISË NË VITE, NË NGRITJEN E AKUZËS NË FAZËN E HETIMIT PARAPRAK**


Nga të dhënat statistikore, rezulton se:

Në vitin 2008 rreth 73,24 % (për qind) e personave për të cilët është ngritur akuzë në fazën e hetimit paraprak janë dërguar për gjykim dhe në vitin 2009 rreth 74,27 % (për qind) e personave për të cilët është ngritur akuzë në fazën e hetimit paraprak janë dërguar për gjykim; në vitin 2010 rreth 68,38% (për qind) e personave për të cilët është ngritur akuzë në fazën e hetimit paraprak janë dërguar për gjykim dhe në vitin 2011 rreth 67,03% (për qind) e personave për të cilët është ngritur akuzë në fazën e hetimit paraprak janë dërguar për gjykim dhe në vitin 2012 rreth 66,22% (për qind) e personave për të cilët është ngritur akuzë në fazën e hetimit paraprak janë dërguar për gjykim.


Rezulton nga të dhënat statistikore se treguesi i efektivitetit të ngritjes së akuzës në fazën e hetimit paraprak ka qenë si më poshtë:

në vitin 2008 janë përfunduar hetimet për 10208 të pandehur nga të cilat 8726 janë dërguar për gjykim dhe për 1482 të pandehur janë pushuar hetimet ose janë dërguar për gjykim 85,48% (për qind) e personave për të cilat është ngritur akuzë; në vitin 2009 janë përfunduar hetimet për 9890 të pandehur nga të cilat 8352 janë dërguar për gjykim dhe për 2013 të pandehur janë pushuar hetimet ose janë dërguar për gjykim 84,44% (për qind) e personave për të cilat është ngritur akuzë; në vitin 2010 janë përfunduar hetimet për 11364 të pandehur nga të cilat 9261 janë dërguar për gjykim dhe për 2103 të pandehur janë pushuar hetimet ose janë dërguar për gjykim 81,49% (për qind) e personave për të cilat është ngritur akuzë; në vitin 2011 janë përfunduar hetimet për 11330 të pandehur nga të cilat 9256 janë dërguar për gjykim dhe për 2074 të pandehur janë pushuar hetimet ose janë dërguar për gjykim 81,69% (për qind) e personave për të cilat është ngritur akuzë; në vitin 2012 janë përfunduar hetimet për 11654 të pandehur nga të cilat 9354 janë dërguar për gjykim 80,26% (për qind) e personave për të cilët është ngritur akuzë.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet efektiviteti i ngritjes së akuzës në fazën e hetimit paraprak për vitin 2012:



Grafiku i mëposhtëm paarqet të dhëna në lidhje me gjininë e të pandehurve në vitet 2008-2012:



Rezulton nga të dhënat statistikore për të pandehurit meshkuj se:




Në në vitin 2008 janë 8870 të pandehur ose rritje prej 4,48% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 janë 7555 të pandehur ose ulje prej 14,82% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 janë 9425 të pandehur ose rritje prej 24,75% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në vitin 2010 janë 10474 të pandehur ose rritje prej 11,12% për qind) në krahasim me vitin 2010 dhe në vitin 2012 janë 11086 të pandehur meshkuj ose rritje prej 5,84% në krahasim me vitin 2011.

Për të pandehurit femra rezulton nga të dhënat statistikore se:

Në vitin 2008 janë 457 të pandehura ose ulje prej 12,6% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 janë 378 të pandehura ose ulje prej 17,28% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 janë 458 të pandehura ose rritje prej 21,16% në krahasim me vitin 2009; në vitin 2011 janë 445 të pandehura ose ulje e lehtë prej 2,83% (për qind) në krahasim me vitin 2010 dhe në vitin 2012 janë 414 të pandehura femra ose ulje prej 6,96% (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Gradfiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me të pandehurit të mitur në vitet 2008-2012:




Në lidhje me të pandehurit të mitur, nga të dhënat statistikore rezulton se:

në vitin 2008 rezultojnë 889 të mitur të pandehur ose 53,27% (për qind) më shumë se në vitin 2007; në vitin 2009 rezultojnë 665 të mitur të pandehur ose 25,19% (për qind) më pak se në vitin 2008; në vitin 2010 rezultojnë 870 të mitur ta pandehur ose rritje prej 30,82% (për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe në vitin 2011 rezultojnë 1015 të pandehur të mitur, që do të thotë rritje prej 16,66% (për qind) në krahasim me vitin 2010 dhe në vitin 2012 rezultojnë 1310 të pandehur të mitur, që do të thotë rritje prej 29,06% (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Në lidhje me të pandehurit të mitur, rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 nga 665 të pandehur, 636 janë meshkuj dhe 29 janë femra. Në vitin 2010, nga 870 të pandehur të mitur, 853 janë meshkuj, që do të thotë rritje prej 34,11% (për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe 17

janë femra, që do të thotë ulje prej 41,37% (për qind) në krahasim me vitin 2009. Në vitin 2011, nga 1015 të pandehur të mitur, 997 janë meshkuj, që do të thotë rritje prej 16,88% (për qind) në krahasim me vitin 2010 dhe 18 prej tyre janë femra.

Grafiku i më poshtëm paraqet të dhëna në lidhje me arsimin e të pandehurve në vitet 2008-2012:



Me arsim deri 9-vjecar:

në 2008 rezultojnë 5942 të pandehur ose 11,31% (për qind) më shumë se në vitin 2007; në vitin 2009 rezultojnë 5123 të pandehur ose 13% (për qind) më pak se në vitin 2008; në vitin 2010 rezultojnë 6069 të pandehur që do të thotë rritje prej 18,46% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në vitin 2011 rezultojnë 6960 të pandehur ose rritje prej 14,68% (për qind) në krahasim me vitin 2010 dhe në vitin 2012 rezultojnë 7158 të pandehur ose rritje 2,84% (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Me arsim të mesëm:


në 2008 rezultojnë 2965 të pandehur ose 5,57% (për qind) më pak se në vitin 2007; në vitin 2009 rezultojnë 2416 të pandehur ose 18,5% (për qind) më shumë se në vitin 2008; në vitin 2010 rezultojnë 3279 të pandehur që do të thotë rritje prej 35,72% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në vitin 2011 rezultojnë 3302 të pandehur, që do të thotë një rritje e lehtë prej 0,7% (për qind) në krahasim me vitin 2010 dhe në vitin 2012 rezultojnë 3509 të pandehur, që do të thotë rritje prej 6,26% (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Me arsim të lartë:

në 2008 rezultojnë 431 të pandehur ose 11,8% (për qind) më pak se në vitin 2007; në vitin 2009 rezultojnë 397 të pandehur ose 7,88% (për qind) më pak se në vitin 2008; në vitin 2010 rezultojnë 486 të pandehur, që do të thotë rritje prej 22,41% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në vitin 2011 rezultojnë 536 të pandehur, që do të thotë rritje prej 10,28% (për qind) në

krahasim me vitin 2010 dhe në vitin 2012 rezultojnë 458 të pandehur ose ulje prej 14,55% (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me gjendjen shoqërore të të pandehurve për vitin 2011:




Përsa i takon gjendjes shoqërore të të pandehurve, për të pandehur të cilët janë të punësuar në sektorin shtetëror, rezulton se në vitin 2011 janë 338 të pandehur nga sektori shtetëror, që do të thotë një ulje e ndjeshme në krahasim me vitin 2010 kur rezultojnë 602 të pandehur nën këtë tregues dhe në vitin 2012 janë 382 të pandehur, që do të thotë rritje prej 13,01% (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Rezulton nga të dhënat statistikore se të pandehur të punësuar në sektorin privat në vitin 2011 rezultojnë 2259 dhe në vitin 2012 rezultojnë 2636 të tillë, që do të thotë rritje prej 16,68% (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Në vitin 2012 rezultojnë 5648 të pandehur të papunë, përkundrajt vitit 2011 kur rezultojnë 5239 të tillë, që do të thotë rritje prej 7,8% (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me vendbanimin e të pandehurve:




Sikurse rezulton edhe nga tabela e mësipërme, në lidhje me vendbanimin e personave të cilët janë marrë të pandehur, theksojmë se nga të dhënat statistikore rezulton:

të pandehur me vendbanim në qytet rezultojnë në vitin 2012 rreth 5529, që do të thotë ulje prej 17,06% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në vitin 2011 të jenë 6667, që do të thotë rritje prej 8,12% (për qind) në krahasim me vitin 2010.

në lidhje me të pandehurit me vendbanim në komunë, rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2012 janë 5456 të pandehur, që do të thotë rritje prej 30,87% (për qind) në krahasim me vitin 2011; 2011 janë 4169 të pandehur, që do të thotë rritje 14,69% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në vitin 2009 gjithsej 3247 të pandehur dhe në vitin 2010 rezultojnë 3635 të pandehur, që do të thotë rritje prej 11,94% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Pavarësisht tendecave në rritje për të dy kategoritë, kriminaliteti mbetet një fenomen i pranishëm më shumë në zonat urbane sesa në zonat rurale.

Grafiku i vijues paraqet të dhëna në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve për vitin 2011:




Përsa i takon gjendjes gjyqësore të të pandehurve, në vitin 2012 rezultojnë 412 të pandehur që janë përsëritës për të njëjtën vepër penale, që do të thotë rritje prej 39,18% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në vitin 2011 rezultojnë 296 të pandehur të cilët janë përsëritës për të njëjtën vepër penale, që do të thotë rritje prej 20,81% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në vitin 2009 rezultojnë të pandehur të cilët janë përsëritës për të njëjtën vepër penale 174 persona dhe në vitin 2010 rezultojnë 245 të tillë që do të thotë rritje prej 40,80% (për qind) në krahasim me vitin 2009;

Përsëritës për vepra penale të ndryshme, rezultojnë në vitin 2012 të jenë 517 persona, që do të thotë rritje prej 26,40% (për qind) në krahasim me vitin 2011; rezultojnë të jenë 409 persona në vitin 2011, që do të thotë rritje prej 7,63% (për qind) në krahasim me vitin 2010; rezultojnë 304 persona në vitin 2009 dhe 380 të tillë në vitin 2010, që do të thotë rritje prej 25% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Të pandehur të padënuar më parë, rezultojnë në vitin 2012 9869 persona, që do të thotë ulje prej 1,59% (për qind) në krahasim me vitin 2011; rezultojnë në vitin 2011 të jenë 10029 të pandehur, që do të thotë rritje prej 9,23% (për qind) në krahasim me vitin 2010; rezultojnë 7407 persona në vitin 2009 dhe 9181 të tillë në vitin 2010, që do të thotë rritje prej 23,95% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me pasojat në dëm të shëndetit:





Në lidhje me pasojat e veprave penale, në dëm të shëndetit, nga të dhënat statistikore rezultojnë se në lidhje me pasojën “vdekje” ka një ulje prej 4,84% (për qind) në krahasim me vitin 2011; prej ka një rritje të lehtë prej 1,73% (për qind) në krahasim me vitin 2010; ka një rënie të pasojës me vdekje nga veprat penale gjatë vitit 2010 prej 36,11% (për qind) në krahasim me vitin 2009 (540 raste në vitin 2009 dhe 345 në vitin 2010).

Pasoja nga veprat penale “plagosje e rëndë” rezulton në vitin 2012 me një rritje prej 8,73% (për qind) në krahasim me vitin 2011; vitin 2011 me një rritje prej 4,13% (për qind) në krahasim me vitin 2010; me ulje, rezulton pasoja nga veprat penale “plagosje e rëndë” dhe ulja është prej 12,31% (për qind) në krahasim me vitin 2009 (276 raste në vitin 2009 dhe 242 në vitin 2010).


Me rritje rezulton edhe në vitin 2012 treguesi në lidhje me pasojën “plagosje e lehtë” prej 1,56% (për qind) në krahasim me vitin 2011; në vitin 2011 edhe pasoja “plagosje e lehtë” është më rritje prej 32,48% (për qind) në krahasim me vitin 2010; me ulje rezulton të jetë dhe pasojë e veprës penale “plagosje e lehtë” rezulton me ulje prej 8,32% (për qind) në krahasim me vitin 2009 (685 raste në vitin 2009 dhe 628 në vitin 2010).

Në shifrat e mësipërme përfshihen pasojat në dëm të jetës dhe të shëndetit të personave, për cdo fakt të dyshuar kriminal të hetuar, pavarësisht nga mënyra e përfundimit të procedimit rreth tij.



**TË DHËNA MBI LLOJET E DËNIMEVE TË KËRKUARA NGA PROKURORËT**


Në lidhje me dënimin me gjobë, grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna për vitet 2008-2012:



Të dhënat statistikore tregojnë për rritje të dënimeve me gjobë (kërkesa të prokurorëve) gjatë vitit 2012 ka një ulje prej 19,86% (për qind) në krahasim me vitin 2011; gjatë vitit 2011 prej 13,8% (për qind) në krahasim me vitin 2010; gjatë vitit 2010 dhe rritja është prej 13,09 % (për qind) në krahasim me vitin 2009; në vitin 2009 ka një ulje të lehtë prej 3,35% (për qind) dhe në vitin 2010 ka rritje prej 13,9% (për qind) kërkime të prokurorit për këtë lloj dënimi.

Vihet re se në vitin 2012 ka një ulje prej 19,16% (për qind); në vitin 2011 ka një rritje të vendimeve të gjykatës për dënimin me gjobë prej 13,17% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në vitin 2010 ka rritje prej 11,32% (për qind) të vendimeve të gjykatës për këtë lloj dënimi; në vitin 2009 ka një ulje prej 2,44% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me masën e dënimit më burgim nën minimumin e parashikuar nga ligji:




Në lidhje me masën e dënimit me burgim në minimum:

Vihet re se në vitin 2012 ka ulje të kërkimeve të prokurorëve në minimum në vitin 2011 prej 2,61% (për qind); në vitin 2011 ka një ulje të kërkimeve të prokurorëve për dënimin me burgim në krahasim me vitin 2010 prej 2,87% (për qind); në vitin 2010 vihet re përsëri ulje e kërkimit të prokurorëve për këtë lloj dënimi prej 30,67% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në vitin 2009 ka një ulje të lehtë prej 4,32% (për qind), kërkime të prokurorit për këtë lloj dënimi.


Vihet re se në vitin 2012 ka rritje prej 5,05% (për qind) të vendimeve të gjykatës për këtë lloj dënimi në krahasim me vitin 2011; në vitin 2011 ka ulje prej 6,52% (për qind) të dënimeve të gjykatës për dënimin me burgim në minimum krahasuar me vitin 2010; në vitin 2010 ka një ulje prej 22,03% (për qind) të vendimit të gjykatës për këtë lloj dënimi në krahasim me vitin 2009; në vitin 2009 ka një rritje të lehtë prej 2,1% (për qind), të vendimeve të gjykatës për këtë lloj dënimi.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me masën e dënimit burgim në maksimum për vitet 2008-2012:



Vihet re se në vitin 2012 ka një rritje prej 17,24% (për qind) të kërkkimeve të prokuroritë për dënimin me burgim në maksimum në krahasim me vitin 2011; në vitin 2011 ka një rritje të kërkkimit të prokurorit për dënimin me burgim në maksimum prej 39,58% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në vitin 2010 ka rritje të ndjeshme prej 56,27% (për qind) të kërkkimeve të prokurorit për këtë lloj dënimi, në krahasim me vitin 2009; në vitin 2009 ka një rritje të lehtë prej 4,87% (për qind), kërkkime të prokurorit për këtë lloj dënimi.

Vihet re se në vitin 2012 ka një rritje prej 20,39% të vendimeve të gjykatës për dënimin me burgim në maksimum në krahasim me vitin 2011; në vitin 2011 ka një rritje të ndjeshme të vendimeve të gjykatës për dënimin me burgim në maksimum prej 103,44% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në vitin 2010 ka ulje prej 5,84% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të vendimeve të gjykatës për dënimin me burgim në maksimum; në vitin 2009 ka një rritje të lehtë prej 4,76% (për qind), vendimeve të gjykatës për këtë lloj dënimi.



Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me zbatimin e nenin 59 të Kodit Penal ku është parashikuar shprehimisht “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë” si kërkime të prokurorit ashtu edhe vendime të gjykatës, në pesë vitet e fundit:




Nga të dhënat statistikore, vihet re se: në vitin 2012 ka një ulje prej 3,53% (për qind) raste të kërkimeve të prokurorit për “Pezullimi I ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në

provë” në krahasim me vitin 2011; në vitin 2011 jemi në të njëjtat nivele sikurse në vitin 2010; kështu në vitin 2010 rezultojnë 1075 raste të kërimit të prokurorit për “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë” ndërsa në vitin 2010 rezultojnë të jenë 10754 raste; në vitin 2010 ka rritje prej 17,63% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të këtij treguesi; në vitin 2009 ka një ulje të lehtë prej 0,97% (për qind), kërime të prokurorit për “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë” në parashikim të nenit 59 të Kodit Penal.

Nga të dhënat statistikore, vihet re se: në vitin 2012 ka një ulje prej 1,18% (për qind) të vendimeve të gjykatës për “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë” në krahasim me vitin 2011; në vitin 2011 ka një rritje të vendimeve të gjykatës për “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë” në parashikim të nenit 59 të Kodit Penal prej 3,34% (për qind) në krahasim me vitin 2010; në vitin 2010 ka rritje prej 13,71% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në vitin 2009 ka rritje prej 1,02% (për qind) në krahasim me vitin 2008 gjykatës për “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë”, në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me masën e dënimit “Burgim i përjetshëm” për periudhën 2008-2012:




Në lidhje me burgimin e përjetshëm, nga të dhënat statistikore rezulton se:

Në vitin 2012 ka një rritje prej 16,66% (për qind) të kërimeve të prokurorit për këtë masë dënimi në krahasim me vitin 2011; në vitin 2011 ka një rritje prej 63,63% (për qind) të kërimeve të prokurorëve për këtë masë dënimi në krahasim me vitin 2010; në vitin 2010 ka ulje prej 26,66% (për qind) në krahasim me vitin 2009 për këtë masë dënimi; në vitin 2009 ka një ulje prej 31,81% (për qind), kërime të prokurorit për masën e dënimit, burgim i përjetshëm.




Nga të dhënat statistikore rezulton se: në vitin 2012 ka një ulje të vendimeve të gjykatës prej 7,69% (për qind) për këtë masë dënimi në krahasim me vitin 2011; në vitin 2011 ka rritje të ndjeshme prej 116,66% në krahasim me vitin 2010; në vitin 2010 ka rritje prej 20% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të vendimeve të gjykatës për këtë masë dënimi; në vitin 2009 ka një ulje prej 61,53% (për qind), kërkime të prokurorit për masën e dënimit.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me këkesat e prokurorëve për dënimin me burgim gjatë vitit 2012:




Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me vendimet e dhëna nga gjykata për vitin 2012 për dënimin me burgim:







Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me vendimet e prokurorit dhe vendimet e gjykes për vitin 2012 në lidhje me dënimin me burgim, dënimin me gjobë dhe me burgimin e përjetshëm:



Grafiku I mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me kërkimet e prokurorit dhe vendimet e gjykatës mbi llojet e dënimeve për vitin 2012:



Grafiku I mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me kërkimet e prokurorit gjatë vitit 2012 mbi llojet e dënimeve:



**TREGUESIT E MARRËDHËNIEVE JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E  
HUAJA PËR VITIN 2012.**

Pjesë shumë e rëndësishme e punës së organit të prokurorisë janë edhe marrëdhëniet juridiksionale me autoritet e huaja. Në vijim po Ju paraqesim të dhëna statistikore në lidhje me fushen e veprimtarisë së prokurorisë shqiptare në këtë drejtim:

❖ Ekstradime nga jashtë

Numri total i te ekstraduerve fizikisht ne Shqipëri është 59, nga të cilët, ashtu si dhe vitet e kaluara, numrim më të madh e zë Italia. Kjo shifër është pothuajse e njëjtë me vitin e kaluar, ku numri total ishte 60 ekstradime.

❖ Ekstradime për jashtë

Në lidhje me kërkesat për ekstradime për jashtë, nga të dhënat statistikore rezulton se gjatë vitit 2011 janë dërguar në Ministrinë e Drejtësisë në total 106 kërkesa për ekstradim, nga të cilat janë realizuar 69 për vitin 2012.

❖ Letërporosi nga jashtë

Në lidhje me ekzekutimin e letërporosive nga jashtë, kemi të administruar një numër prej 582 kërkesa për ekzekutim të tyre, nga të cilat janë ekzekutuar 104 letërkërkesa. Numrin më të madh e zënë vendet si Kosova (110 raste), Greqia (143 raste), Italia (64 raste), Mali i Zi (43 raste), Turqi (27 raste), etj.

❖ Njohje vendimesh penale të huaja

Në lidhje me njohjet e vendimeve penale të huaja nga shteti shqiptar, kemi një numër total prej 46 njohje vendimesh, ku vetëm 32 prej tyre vendime të autoriteteve Kosovare, 7 të Italisë, etj. Në lidhje me njohjet e vendimeve penale të huaja me Kosovën, kryesisht janë njohje vendimesh për dënime me gjoba të ulta për kalim të paligjshëm të kufirit.

❖ Njohje vendimesh penale shqiptare për jashtë

Në lidhje me njohjen e vendimeve penale shqiptare për jashtë jashtë, kemi një total prej 12 njohje, nga të cilat 7 janë me Kosovën, 2 me Maqedoninë, 1 me Malin e Zi, 1 me Bullgarinë dhe 1 me Italinë.

❖ Transferime procedimesh nga jashtë

Gjatë vitit 2012, numri i transferimeve të procedimeve nga jashtë është 12, kryesisht me Greqinë (6 raste) dhe me Kosovën (4 raste).

❖ Transferime procedimesh për jashtë

Gjatë vitit 2012, numri i transferimeve të procedimeve për jashtë është 5 raste, 3 nga të cilat janë me Kosovën, 1 me Italinë dhe 1 me Greqinë.

❖ Transferime personash të dënuar për jashtë

Gjatë vitit 2012, numri i personave të dënuar për jashtë është 3, konkretisht 2 për Greqi dhe 1 për Francë.

❖ Shpallje në kërkim ndërkombëtar.  
Për vitin 2012, janë realizuar gjithsej 117 shpallje në kërkim ndërkombëtar.

❖ Heqje nga kërkimi ndërkombëtar  
Për vitin 2012, janë realizuar gjithsej 99 heqje nga kërkimi ndërkombëtar.

❖ Kërkesa të ndryshme nga autoritetet e huaja  
Gjatë vitit 2012 janë bërë rreth 283 kërkesa të ndryshme nga autoritetet e huaja, nga të cilat janë realizuar 34 prej tyre.

## **ANALIZË E GRUPTREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE TË PUNËS SË PROKURORISË**

Arritjet në përmbushjen e angazhimeve për prioritetet në luftën kundër kriminalitetit. Në luftën kundër kriminalitetit, prioritet tona gjatë vitit 2012 kanë qenë: strategjitë kombëtare të miratuara, progresi i raportit dhe rekomandimet që vijnë nga partnerët e huaj për shkak të angazhimeve të shtetit shqiptar në organizmat ndërkombëtarë, si dhe problematikat e punës së organit të prokurorisë dhe tendencat e kriminalitetit të evidentuara gjatë vitit 2011; - korrupsioni; - krimi i organizuar; - terrorizmi; - trafiket e paligjshme; - pastrimit të parave; - veprave penale të vjedhjes së pasurisë; - veprave penale që lidhen me shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor.

### **KRIMI I ORGANIZUAR DHE TRAFIQET**

Gjatë vitit 2012 në Prokurorinë për Krime të Rënda u hetuan 3383 procedime, nga të cilat 94 të mbartura nga vitet e mëparshme dhe 244 të regjistruara rishtazi gjatë vitit që kaloi. Kanë marrë zgjidhje 196 procedime, ndërkohë që u mbartën për vitin 2013, 139 procedime. Vihet re rritje e ndjeshme e numrit të procedimeve të regjistruara rishtazi (135 më shumë se sa vitin 2011). Referimet nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit vazhdojnë të mbeten në të njëjtat nivele, me një rritje prej 5 procedimesh nga viti i kaluar – 20 procedime. Ndërkohë, kanë marrë zgjidhje përfundimtare 196 procedime, rreth 65 procedime më shumë në krahasim me vitet e kaluara (131 – v.2011; 132 – v.2010). Për shkak të rritjes së ngarkesës (dhe pakësimit të numrit të prokurorëve) edhe numri i çështjeve të mbartura për këtë vit pësoi rritje (139; mesatarja e pesë viteve të shkuara është 97 procedime). Rezulton se puna e përballuar në hetime, referuar numrit të procedimeve, u rrit ndjeshëm në raport me vitet e kaluara. Faktori kryesor është rritja e numrit të rasteve të flagrancës në pikat e kalimit kufitar.

Në përfundim të hetimeve u dërguan për gjykim 80 çështje, u pushuan 33 procedime dhe u pezulluan 52. Në gjyq u dërguan 48% e numrit të procedimeve të zgjidhura, që konsiderohet një tregues shumë i mirë.

Ndër grupveprat penale të hetuara, ashtu si vitet e kaluara, pjesën dërmuese e përbëjnë krimet e trafikimit të lëndëve narkotike (187 procedime – 56%), shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë (54 procedime – 16%), trafikimi i qënieve njerëzore (29 procedime – 8,6%), trafikimi i armëve dhe i municioneve (22 procedime – 6,5%), vrasjet e

<sup>3</sup> Nga numri i procedimeve të regjistruara janë zbritur 3 procedime të bashkuara me procedimet në hetim.

kryera ndaj personave me cilësi të veçanta (14 procedime – 4%), veprat e ndryshme penale të kryera nga organizata kriminale dhe grupe të strukturuar (13 procedime – 3,6%), rrëmbimi i personit (11 procedime – 3,3%).

Analiza e të dhënave tregon se, në raport me mesataren e viteve 2009, 2010, 2011, numri i procedimeve për trafikim të lëndëve narkotike është rritur 3,5 herë. Numri i procedimeve të regjistruara për trafikim të qënieve njerëzore, me një rrije të ndjeshme nga 2009-a në 2010-ën (nga 9 në 36 raste), shënoi përsëri një rritje të ndjeshme në raport me vitin 2011 (nga 7 në 29 procedime). Rritje të ndjeshme pati numri i rasteve të shtrëngimit me anën e kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë (nga 24 në 54 procedime). Rritje shënuan edhe rastet e trafikimit të armëve dhe të rrëmbimit të personit. Gjithashtu, tendenca për krime të kryera nga organizata ose grupe të strukturuar raportohet në rendin rritës (nga 3 procedime të regjistruara gjatë vitit 2011, në 13 procedime për vitin 2012).

Gjatë vitit 2012 u vunë nën hetim 348 persona, 145 më shumë se në vitin 2011. Nga këta, 142 u dërguan për gjykim dhe 140 u mbartën për vitin në vazhdim. U pushuan hetimet ose akuzat për 46 subjekte, ndërsa procedimet për 20 subjekte u transferuan për kompetencë në prokuroritë e tjera.

Ndër 142 subjektet e dërguar për gjykim, pjesa më e madhe e tyre (132) kanë qenë nën masën e sigurimit arrest në burg (120 në fakt dhe 12 në mungesë), kurse 3 prej tyre nën masën e arrestit në shtëpi. Ndërkohë, 4 subjekte kanë qenë nën masën e sigurimit detyrim për paraqitje në PGJ, kurse 3 pa masë sigurimi.

U pushuan akuzat ose çështjet për 46 persona, nga të cilët 4 kanë qenë me arrest në burg (3 të arrestuar në fakt), 3 me detyrim për paraqitje, 38 persona pa masë sigurimi dhe 1 me detyrim qëndrimi. Sikurse edhe në vitet e kaluara, kërkesat për masa sigurimi janë parë me kujdes, për të shmangur arrestimet e nxituara që nuk mbështeteshin nga prova fajësie.

Çështjet e dërguara për gjykim, sipas llojit të veprave penale. Numrin më të madh të tyre (53 çështje ose 20 më shumë se vitin e kaluar) dhe të personave të akuzuar (79 të pandehur ose 22 më shumë se 2011-ta) e përbëjnë, sikurse edhe vitet e kaluara, trafikimi i lëndëve narkotike. Vitin që shkoi u dërguan për gjykim dy çështje për vepra të kryera nga organizata dhe grupe të strukturuar kriminale (gjatë vitit 2010 u dërguan tri çështje, gjatë 2011-ës 1 çështje). Vërehet dyfishim i numrit të çështjeve të dërguara në gjyq për akuzat e shtrëngimit për dhënien e pasurisë dhe trafikimit të armëve.

Gjatë vitit 2012, për dënimet me burgim vërehet e njëjta politikë dënimesh si në vitin e kaluar, pa ndryshime të ndjeshme. Rastet e pakta të gjykuara për akuzat e vrasjes së cilësuar dhe të trafikimit të njerëzve, nuk lejojnë të nxirren konkluzione për plolitikën e dënimit (edhe pse në terma absolute vihet re ashpërsim i dënimeve. Për krimet e trafikimit të njerëzve dhe të lëndëve narkotike, gjatë vitit 2012, vazhdoi e njëjta politikë dënimi, mjaft e ashpër për rastin e narkotikëve, ndonëse për sasi të vogla jemi orientuar drejt minimumit të dispozitës. Kjo kushtëzohet nga sanksionet e larta që parashikon Kodi Penal, pa bërë dallim midis llojeve të ndryshme të lëndëve narkotike.

**HETIMET PASURORE NË ZBATIM TË LIGJIT NR.10192, DATË 3.12.2009 “PËR PARANDALIMIN DHE GODITJEN E KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE TRAFIKIMIT NËPËRMJET MASAVE PARANDALUESE KUNDËR PASURISË”**



Gjendja e zbatimit të ligjit në fuqi nga viti 2010 për sekuestrimin e aseteve kriminale paraqitet si vijon:

Përveç veprimtarisë verifikuese që kryejnë prokurorët e Prokurorisë për krime të Rënda për procedimet që hetojnë, prokurorët e seksionit të posaçëm kanë marrë në shqyrtim edhe materiale referues me origjinë nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, drejtoritë e policisë në qarqe dhe nga vetë veprimtaria hetimore e prokurorëve të seksionit.

Janë paraqitur 8 kërkesa për sekuestrim, të cilat janë pranuar nga gjykata, me përjashtim të një rasti kur gjykata e apelit ka revokuar pjesërisht vendimin e shkallës së parë;

Janë paraqitur 3 kërkesa për konfiskimin e pasurive të sekuestruara, të cilat janë pranuar (plotësisht ose pjesërisht). Një kërkesë u pranua pas procesit të rigjykimit.

Lidhur me zbatimin e ligjit në fjalë, ka patur edhe gjatë vitit 2012 një problematikë që mund të përmblihet si vijon:

**ME PROKURORITË E RRETHEVE GJYQËSORE.** - Kërkesat e tyre për fillimin e procedimit pasuror, kryesisht, referohen për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”. Konstatohet mangësitë vijuese:

i) Regjistrohen çështje të cilat nuk përmbushin kriteret bazë për regjistrim sipas nenit 287 të KP. Për më tepër, vepra jo vetëm nuk i atribuohet ndonjë personi konkret (përmes regjistrimit të emrit në regjistër), por rezulton se personat pyeten në cilësinë cilësinë e personave që kanë dijeni për veprën penale dhe jo si persona nën hetim.

ii) Nuk bëhet kujdes lidhur me formulën e pushimit të hetimeve për veprën bazë që ata hetojnë; ka raste kur pushimi është bërë me argumentin se fakti nuk parashikohej nga ligji si vepër penale. Në raste të tilla nuk ka si të kryhet hetim pasuror;

iii) Shpesh hetimet nuk janë të plota, nuk përfshijnë të gjithë rrethin e personave që parashikon ligji dhe Urdhëri nr.106, datë 18.05.2010 i Prokurorit të Përgjithshëm; në disa materiale, nuk analizohen elementet ligjore që mundësojnë një hetim pasuror, si periudha e veprimtarisë kriminale, koha e krijimit të pasurive të identifikuar, burimet nga janë krijuar këto pasuri, etj. Ka shumë raste ku rezulton se pasuritë e identifikuar janë krijuar shumë kohë para përfshirjes së subjektit në veprimtari kriminale.

**E DREJTORITË E POLICISË NË QARQE.** – Konstatohet problematikën vijuese:

i) Dërgohen materiale për shtetas shqiptarë që banojnë jashtë shtetit, duke referuar se kanë kryer aktivitet të paligjshëm apo se janë dënuar, ndërkohë që mungon dokumentacioni i nevojshëm për të vërtetuar sa më sipër; në materiale të tjera nuk evidencohet dyshimi i arsyeshëm i bazuar në indicje se pronari i pasurive ka kryer njëherë nga veprat që kërkon ligji;

ii) Konstatohen raste kur, megjithëse prokuroria përkatëse vazhdon hetimet, policia referon materialin për hetim pasuror pa koordinuar me prokurorinë, që ndërkohë mund t'i kete kryer verifikimet e nevojshme;

iii) Ende nuk ka asnjë referim për pasuri me origjinë kriminale të fshehura në emër të të tretëve, ndonëse në kushtet e ekonomisë informale kjo është plotësisht e mundshme;

iv) Identike me pikën iii) të problematikës së prokurorive në rrethe.



Cilësia e referimeve për hetimet proaktive vazhdon të përbëjë një problem, sidomos në drejtim të nivelit të aktivitetit kriminal të referuar apo të subjekteve të përfshirë në të, i cili kufizohet në rastet e trafikimit rutinë, larg nivelit të krimit të organizuar. Përbën një problem fakti se nuk shënohet rritje të shifrave që lidhen me hetimin e grupeve të strukturuar apo organizatave kriminale të përfshira në trafikimin e lëndëve narkotike. Dallohet nga shifrat se ndonëse numri i përgjimeve telefonike, ambientale apo autorizimeve për kryerjen e veprimeve të posaçme hetimore ka qenë i konsiderueshëm, rezultate nuk janë shënuar. Kapjet e sasive të mëdha të lëndëve narkotike në pikat e kalimit kufitar, në mënyrë krejt rastësore, edhe në sasi të konsiderueshme, tregon se përmasat e fenomenit vazhdojnë të mbeten shqetësuese. Kjo panoramë ka ndikuar drejtpërdrejt edhe në hetimet pasurore, pasi subjektet e hetuar, më së shumti korrierë, shpesh rezultojnë pa prona, llogari bankare dhe pa veprimtari biznesi.

Duke vlerësuar këtë situatë, realizimi i këtyre objektivave për vitin 2013 mbetet një sfidë, pasi përveç angazhimit tonë maksimal, kërkohet një angazhim shumë më i madh nga strukturat e Policisë së Shtetit në luftën ndaj krimit të organizuar, si në nivel organizativ, ashtu edhe në vënien në dispozicion të burimeve të duhura njerëzore e teknike. Në vlerësojmë se përmirësimet në këtë drejtim, do të ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e suksesit në hetimet proaktive, që përbëjnë prioritetin tonë kryesor, por njëkohësisht do të sjellin edhe përmirësime në drejtim të identifikimit, sekuestrimit e konfiskimit të aseteve kriminale.

Një element pozitiv gjatë vitit që shkoi ka qenë bashkëpunimi i ngushtë me autoritetet e huaja, i cili vazhdon të jetë rezultativ, megjithëse mendojmë se ka vend për zgjerimin e mëtejshëm të tij. Gjithashtu, ne vlerësojmë se janë hapësirat dhe kapacitetet e nevojshme për të vazhduar me kryerjen e hetimeve paralele me strukturat homologe në vendet e Europës Perëndimore.

## **VJEDHJA**

Ky grup veprash penale kanë qenë në prioritetet e punës së organit të prokurorisë edhe për vitin 2012. Nga analiza e të dhënave statistikore për këtë grup veprash penale, vlen të theksojmë faktin se Pësha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2012 është 42,03 % (për qind), për vitin 2011 40,63 % (për qind) përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2012 në krahasim me vitin 2011.

Nga analiza e të dhënave statistikore vihet re se në vitin 2012 ka një rritje prej 15,78 % (për qind) të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vjedhja e pasurisë” në krahasim me vitin 2011. Ndërkaq kemi ulje prej 3,7 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2011. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2011 prej 8,51 % (për qind); një rritje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 8,32 % (për qind) dhe kemi rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 3,27 % (për qind) përkundrejt vitit 2011.

Organi i prokurorisë ka ashpërsuar politikën e dënimit ndaj autorëve të këtyre veprave penale. Ky qëndrim del qartë në pah në analizën e treguesve statistikore të kërkesave të prokurorëve për llojet dhe masat e dënimit.

Edhe gjatë vitit 2012, vihet re rritje shqetësuese e numrit të procedimeve të pezulluara për të gjitha shkaqet që parashikon shprehimisht ligji (ku pjesën më të madhe e zënë pezullimet për “moszbulim të autorit të krimit”) për këtë grup veprash penale.

Kështu, nga të dhënat statistikore, ky tregues ndër vite rezulton të jetë:

Në vitin 2012 janë 8646 procedime të pezulluara për moszbulim të autorëve të krimit, që do të thotë 98,84% e të gjitha procedimeve të pezulluara gjatë vitit 2012; në vitin 2011 kjo e dhënë rezulton të jetë 5872 procedime, që do të thotë 74,36% (për qind) e të gjitha procedimeve të pezulluara gjatë vitit 2011; në vitin 2010 janë 4992 procedime të pezulluara për moszbulim të autorëve të krimit, që do të thotë 73,25% e të gjitha procedimeve të pezulluara dhe në vitin 2009 janë 4071 procedime të pezulluara, që do të thotë 68,84% e të gjitha procedimeve të pezulluara;

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, rezulton nga të dhënat statistikore se ka një rritje të konsiderueshme të të pandehurve të mitur (14-18 vjec) të përfshirë në këtë lloj kriminaliteti, prej 27,31% (për qind) në krahasim me vitin 2011. Përsa i takon gjëndjes gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 2536 të pandehur, 350 prej tyre janë përsëritës për të njëjtën vepër penale (rritje prej 73, 26% në krahasim me vitin 2011), ndërsa 189 të pandehur janë përsëritës për vepra penale të ndryshme (rritje prej 35,97%) në krahasim me vitin 2011.

## **SHKELJA E RREGULLAVE TË QARKULLIMIT RRUGOR**

Vihet re tendenca në rritje e procedimeve të rregjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, në vitin 2012, prej 2,12 % (për qind) në krahasim me vitin 2011; ka një ulje të numrit të procedimeve penale të dërguara gjyqit prej 7,53% (për qind) në krahasim me vitin 2011; ka një ulje të numrit të të pandehurve të regjistruar prej 8,09% (për qind) në krahasim me vitin 2011; me ulje rezulton të jetë edhe numri I të pandehurve të dërguar gjyqit, ulje prej 4,14% (për qind) si dhe numri I të pandehurve të dënuar nga gjykata, ulje prej 7,58% (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” është 23,83 % (për qind) për vitin 2012, ndërkohë që në vitin 2011 ka qenë 26,41% (për qind).

Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2008 dhe 2009 janë regjistruar nga 851 procedime penale; në vitin 2010 ka ulje prej 9,16% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2011 ka ulje prej 2,45% (për qind) në krahasim me vitin 2010 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2012 ka rritje prej 2,12% (për qind) në krahasim me vitin 2011 të procedimeve penale të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 290 “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” i Kodit Penal.

## **PASTRIMI I PRODUKTEVE TË VEPRËS PENALE**

Ushtrimi i ndjekjes penale ndaj autorëve që kryejnë “Pastrimin e produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, ka vazhduar të jetë një prioritet i punës së prokurorisë edhe gjatë vitit 2012. Është punuar për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet të gjitha strukturave të zbatimit të ligjit që merren me parandalimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale në këtë drejtim.

Janë organizuar trajnime, takime pune, analiza, shkëmbyer informacione në mënyrë të vazhdueshme me të gjithë faktorët, me qëllim rritjen e efektivitetit të ndjekjes penale ndaj kësaj vepre penale, me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Ndikim pozitiv ka dhënë edhe implementimi i Projektit të Binjakëzimit me autoritetet spanjolle dhe bullgare, i financuar nga Komisioni Evropian.

Në vitin 2012 vihet re tendenca në rritje e procedimeve të rregjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale”, prej 121,27 % (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Në vitin 2012, janë dërguar për gjykim 8 procedime penale për këtë veprën penale, që do të thotë rritje prej 14,28% (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Në vitin 2012 janë regjistruar 26 të pandehur për këtë veprën penale, përkundrajt 134 të tillë në vitin 2011, që do të thotë një rritje e këtij treguesi për vitin 2012 prej 100% (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Është ngritur akuza në gjykatë për 13 të pandehur, ndërkohë që në vitin 2011 kjo shifër rezultoi të jetë 11.

Për këtë veprën penale, në vitin 2012 rezultojnë 4 të dënuar nga gjykata, përkundrajt 1 (një) të dënuari nga gjykata në vitin 2011.

## **PËRMBLEDHJE E TENDENCAVE TË KRIMINALITETIT PËR VITIN 2012 SIPAS GRUPVEPRAVE PENALE**

### **II.1 TENDENCAT NË RITJE:**

#### **Vepra penale kundër personit, “Krime kundër jetës të kryera me dashje”**

- 1- Neni 79 i Kodit Penal “Vrasja në rrethana rënduese”,
- 2- Neni 83 i Kodit Penal “Vrasja në kapërcim të mbrojtjes së nevojshme”,

Lidhet me uljen e sigurisë publike në konsekuencë të ndikimit të faktorëve socialë dhe ekonomike, të brendshëm dhe të jashtëm. Në këto kushte, cmohet e domosdoshme rritja e bashkëpunimit të gjitha institucioneve ligjzbatuese për rritjen e zbulueshmërisë të autorëve të këtyre veprave penale dhe vënien e tyre para ligjit. Gjithashtu, është i nevojshëm dhe aplikimi i një politike penale më të ashpër ndaj këtyre individëve nga ana e sistemit të drejtësisë

#### **Vepra penale kundër lirisë së personit**

- 1- tendenca në rritje e procedimeve të rregjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 109/b i Kodit Penal “Shtrengimi me anë të kanosjes ose dhnunës për dhënien e pasurisë”, në vitin 2012, prej 63,63 % (për qind) në krahasim me vitin 2011.

Për këtë grup veprash penale tendenca përgjithësisht shpjegohet sikurse në rastin e veprave penale kundër personit, “Krime kundër jetës të kryera me dashje.

### **Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes**

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2012 është 1,68% (për qind) dhe në vitin 2011 ishte 0,19% (për qind).

- 1- tendenca në rritje e procedimeve të rregjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 124 i Kodit Penal “Braktisja e fëmijëve të mitur”, në vitin 2012, prej 35,71 % (për qind) në krahasim me vitin 2011. Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” është 44,18 % (për qind) për vitin 2012, ndërkohë që në vitin 2011 ka qenë 35,89% (për qind). Në këtë grup veprash penale vihet re se në vitin 2012 janë regjistruar 328 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal “Dhuna në Familje”. Janë dërguar për gjykim 159 procedime penale nga ana e organit të prokurorisë në vitin 2012; janë regjistruar 255 të pandehur dhe është ngritur akuza në gjykatë për 171 të pandehur; janë dënuar nga gjykata 69 të pandehur për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal “Dhuna në Familje”.

Me gjithëse një vepër e re penale e parashikuar në ndryshimet e fundit të Kodit Penal, procedimet e regjistruara për këtë vepër penale tregon se duhet t’i jepet vëmendje e duhur dhe se dhuna në familje në shoqërinë tonë ka qenë një fenomen i përhapur dhe shqetësues. Mendojmë se penalizimi me një dispozitë konkrete në Kodin Penal ishte i domosdoshëm për parandalimin edhe luftimin e këtij fenomeni.

### **Veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, “Vjedhja e Pasurisë”**

- 1- neni 134 i Kodit Penal “Vjedhja”;
- 2- neni 135 i Kodit Penal “Vjedhja e kryer duke shpoërdoruar detyrën” ;
- 3- neni 139 i Kodit Penal “Vjedhja me dhunë”, në vitin 2012;
- 4- neni 140 i Kodit Penal “Vjedhja me armë”;

Në tendencën sërish në rritje edhe në vitin 2012 të këtij grup-veprash penale çmojmë se ndikojnë faktorët social dhe ekonomikë dhe ulja vit pas viti e zbulueshmërisë së autorëve të tyre. Konstatohet rritje e numrit e të pandehurve të mitur për këtë grup veprash penale. Vlerësojmë që mungesa e një sistemi efikas për ndëshkueshmërinë penale ndaj kësaj kategorie individësh (konsideruar moshën, edukimin, kushtet e jetesës, prejardhjen familjare, etj.) është një faktor që ka ndikuar në rritjen e numrit të rasteve të këtij grupi veprash penale.

### **Vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare**

- 1- Neni 170/a i Kodit Penal “Punësimi i paligjshëm”;

Kjo rritje e regjistrimeve të veprave penale të kësaj kategorie mendojmë se është rrjedhojë e rritjes së përgjegjshmërisë së strukturave shtetërore që kanë detyrim evdientimin e rasteve të punësimit të paligjshëm.

### **Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet**

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2012 është 0,59 % (për qind), për vitin 2011 0,57 % (për qind) përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2012 në krahasim me vitin 2011.

1- neni 181 i Kodit Penal “Mospagimi i taksave dhe i tatimeve”.

Edhe në rritjen e procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale, jemi të mendimit se vlen I njëjti koment sikurse për nenin 170/a të kodit penal “Punësimi i paligjshëm”.

### **Falsifikimi i dokumenteve**

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2012 është 5,50 % (për qind), për vitin 2011 5,02 % (për qind) përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2012 në krahasim me vitin 2011.

- 1- neni 188 i Kodit Penal “Falsifikimi i dokumenteve shëndetësore;
- 2- neni 189 i Kodit Penal “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”;
- 3- neni 190 i Kodit Penal “Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve.

### **Vepra penale që çënojnë regjimin juridik të tokës**

- 1- neni 199/a i Kodit Penal “Ndërtimi i paligjshëm.
- 2- Neni 200 i Kodit Penal “Pushtimi i tokës”.

### **Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik**

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2012 është 1,91 % (për qind), për vitin 2011, 1,62 % (për qind) përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2012 në krahasim me vitin 2011.

- 1- neni 248 i Kodit Penal “Shpërdorim detyre.
- 2- neni 250 i Kodit Penal “Kryerja e veprimeve arbitrare”.
- 3- neni 258 i Kodit Penal “Shkelja e barazisë në tendera apo ankande publike”.

### **Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike**

- 1- neni 262 i Kodit Penal “Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme”.
- 2- neni 272 i Kodit Penal “Njoftimi rremë në organet e rendit”.
- 3- neni 275 i Kodit Penal “Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike”.
- 4- neni 277 i Kodit Penal “Vetëgjyqësia”.
- 5- neni 278 i Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit” i Kodit Penal.”.

- 6- neni 279 i Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta”.
- 7- neni 280 i Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”.
- 8- neni 288/a i Kodit Penal “Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industriale dhe ushqimorë”.
- 9- neni 289 i Kodit Penal “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë”.
- 10- neni 290 i Kodit Penal “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”.

### **Vepra penale që lidhen me pastrimin e parave**

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2012 është 0,56 % (për qind), për vitin 2011 0,28 % (për qind) përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2012 në krahasim me vitin 2011.

- 1- neni 287 i Kodit Penal “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale.
- 2- neni 287/b i Kodit Penal “Përvetesimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale”.

### **Vepra penale kundër korrupsionit**

- 1- neni 245/1 i Kodit Penal “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”
- 2- neni 259 i Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i personave me funksione publike”.

### **Vepra penale kundër drejtësisë**

- 1- neni 306 i Kodit Penal “Dëshmia e rreme”
- 2- neni 309 i Kodit Penal “Ekspertimi i rremë”.
- 3- neni 321 i Kodit Penal “Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës”.
- 4- neni 323 i Kodit Penal “Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit”.

### **Krimi kompjuterik**

- 1- neni 143/b i Kodit Penal “Mashtrimi kompjuterik”.
- 2- neni 192/b i Kodit Penal “Hyrja e paautorizuar kompjuterike”.

### **Vepra penale me qëllime terroriste**

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2012 janë regjistruar 4 procedime penale për këtë grup veprash penale, përkundrejt 1 procedimi penale të regjistruar në vitin 2011. Është dërguar për gjykim 1 procedim penal në vitin 2012, përku ndrejt 1 të tillë në vitin 2011. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, është regjistruar 1 i pandehur në vitin 2012; për 5 të pandehur është ngritur akuza në gjykatë në vitin 2012 dhe janë dënuar nga gjykata 4 të pandehur në vitin 2012.



2 procedime penale janë regjistruar për veprën penale të pasrashikuar nga neni 230 i Kodit Penal Neni 230/a “Financimi i terrorizmit” dhe Neni 232/b “Kanosja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste”.

### **Trafiqet e paligjshme**

- 1 neni 114/b i Kodit Penal “Trafikimi i femrave”.
- 2 ë i Kodit Penal “Trafikimi i armëve dhe i municionit”.
- 3- neni 283/a i Kodit Penal “Trafikimi i narkotikëve”.

## **II.2 TENDENCAT NË ULJE:**

### **Krime kundër jetës të kryera me dashje**

- 1- neni 76 i Kodit Penal “Vrasja”.
- 2- neni 78 i Kodit Penal “Vrasja me Paramendim”.
- 3- neni 79 i Kodit Penal “Vrasja në rrethana rënduese”.

### **Krime kundër jetës shkaktuar me pakujdesi**

- 1- neni 85 i Kodit Penal “Vrasja nga pakujdesia”.

### **Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtazanisë ose moshdënia e ndihmës**

- 1- neni 99 i Kodit Penal “Shkaktimi i vetëvrasjes”.

### **Krime seksuale**

- 1- Neni 101 i Kodit Penal “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”.

### **Vepra penale kundër lirisë së personit**

- 1- Neni 112 i Kodit Penal “Dhunimi i banesës”.

### **Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit**

- 1- Neni 113 i Kodit Penal “Prostitucioni”.
- 2- Neni 114 i Kodit Penal “Shfrytëzimi i prostitucionit”.
- 3- Neni 114/a i Kodit Penal “Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese”.

### **Mashtrimet**

- 1- neni 143 i Kodit Penal “Mashtrimi”.

#### **Shkatërrimi i pronës**

- 1- neni 151 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës me zjarr”.
- 2- neni 154 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës me mjete të tjera”.
- 3- neni 156 i Kodit Penal “Shkatërrimi i rrjetit elektrik”.
- 4- neni 150 i Kodit Penal “Shkatërrimi i rrjetit të ujës-jellësit”.

#### **Krime në fushën e doganave**

- 1- neni 174 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra të tjera”.
- 2- neni 178 i Kodit Penal “Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë”.

#### **Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë**

- 1- neni 183 i Kodit Penal “Falsifikimi i monedhave”.

#### **Krime kundër autoritetit të shtetit**

- 1- neni 236 i Kodit Penal “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”.
- 2- neni 237 i Kodit Penal “Goditjet për shkak të detyrës”.

#### **Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve**

Në vitin 2012 ka një ulje prej 96 % (për qind) të numrit të procedimeve të rregjistruara për “Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve” në krahasim me vitin 2011. Ndërkaq kemi ulje prej 25 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2011. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të rregjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2011 prej 100 % (për qind); një rritje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 7,14 % (për qind) dhe kemi rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 16 të dënuar për vitin 2012, përkundrejt vitit 2011 kur nuk është regjistruar asnjë i dënuar nga gjykata.

Në vitin 2012 është regjistruar 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 326 I Kodit Penal “Falsifikimi i dokumenteve dhe rezultateve të zgjedhjeve” në prokurorinë e rrethit gjyqësor Korçë.

#### **Vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë**

- 1- neni 297 i Kodit Penal “Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror”.

#### **Trafikët e paligjshme**

- 1- neni 141/a i Kodit Penal “Trafikimi i mjeteve motorike”.

### **REFORMIMI I PROKURORISË GJATË VITIT 2012**

Prokuroria shqiptare konsideron në mënyrë të vazhdueshme, reformimin e brendshëm, si një element vital për mirëfunksionimin e institucionit. Në këtë drejtim, duke shfrytëzuar asistencën e partnerëve ndërkombëtarë edhe të misionëve të huaja që asistojnë e mbështesin punën e

prokurorisë, janë miratuar një sërë aktesh normative të cilat janë të drejtuara drejt vendosjes së rregullave për organizimit dhe funksionimit edhe të prokurorive të rretheve gjyqësore. Miratimi i këtyre akteve është bërë duke u mbështetur në ligjin organik të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë dhe në rekomandimin nr. 19/2000 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, rekomandimet e Raport-progresit të Komisionit European për Shqipërinë.

**GJATË VITIT 2012 JANË HARTUAR KËTO AKTE NORMATIVE TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM:**

Gjatë vitit 2012 janë hartuar këto akte normative të Prokurorit të Përgjithshëm:

- Urdhër i përbashkët 1004/2 13.04.2012, ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm, Minsitrit të Drejtësisë dhe Minsitrit të Brendshëm, “Për ngritjen e grupit të punës për krijimin e formatit të standardizuar për sistemin e konsoliduar të të dhënave për veprat penale të korrupsionit dhe për krijimin e formatit të standardizuar për sistemin e konsoliduar të të dhënave për veprat penale që lidhen me korrupsionin”. Nxjerrja e këtij urdhri erdhi si një domosdoshmëri për zbatimin e objektivave dhe masave të planit të veprimit të Rekomandimit Nr.8 “Lufta kundër korrupsionit” dhe të Rekomandimit nr. 9 “Lufta kundër krimit të organizuar” të Komisionit Evropian për Shqipërinë. Sa parashikohet në këtë urdhër është implementuar me sukses, janë hartuar tabelat e standardizuara dhe raportohen periodikisht të dhënat e kërkuara;
- Udhëzimi i përbashkët me nr. 2 date 14.05.2012, “Për procedurat e konkurrimit për caktimin në seksion të punonjësve të Policisë Gjyqësore”, i cili është hartuar në bazë dhe për zbatim të ligjit nr.8677, datë 2.11.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, (i ndryshuar) dhe ka për qëllim që nëpërmjet vendosjes së rregullave dhe procedurave të njëjta për caktimin e oficerëve në seksionet e Policisë Gjyqësore të formojë seksione të Policisë Gjyqësore me personel të përgjegjshëm, profesional dhe eficient;
- Urdhri nr.125 date 19.06.2012 “Për krijimin dhe administrimin e regjistrave në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë”, i cili ka për objekt përcaktimin e rregullave të njëjta për regjistrimin e të dhënave në regjistrat e Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë dhe standartizimin e regjistrave duke përcaktuar modelin e tyre. Këto regjistra pasqyrojnë të gjithë veprimtarinë procedurale të organit të prokurorisë në mënyrë të detajuar dhe lejojnë që regjistrimi dhe përpunimi i të dhënave të jetë edhe më eficient. Nga ana tjetër krijimi i këtyre regjistrave i shërben edhe projektit të BE për prokurorinë “menaxhimi i rasteve” i cili hyn në fazën e implementimit;
- Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e prokurorive pranë gjykatave të rretheve gjyqësore. U hartua një projekt-rregullore ku u përcaktuan shtyllat kryesore mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Prokurorive të Rretheve Gjyqësore, mbi administrimin e regjistrave penalë dhe dokumenteve të krijuara apo të ardhura në adresë të prokurorisë. Në hartimin e saj, vëmendje të veçantë i është kushtuar transparencës në drejtimin dhe organizimin e punës, por gjithashtu edhe të drejtës për akses të publikut në rastet dhe

format e parashikuara nga ligjet në fuqi. Ky akt u plotësua dhe miratua nga çdo prokurori në përputhje me strukturën e saj.

- Urdhër nr.221 datë 19.11.2012 “Për miratimin e rregullores për sistemin e vlerësimit të punës dhe të aftësive profesionale e morale të prokurorëve”. Qëllimi i sistemit të vlerësimit të punës dhe të aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve synon realizimin e një procesi për rritjen e përgjegjësisë së prokurorëve në ushtrimin e funksioneve kushtetuese dhe ligjore, ndjekjen e karrierës duke përzgjedhur në mënyrë të drejtë dhe transparente kandidatët, promovimin e qëndrueshmërisë në detyrë të prokurorëve si dhe identifikimin e mangësive profesionale dhe nevojat për trajnimin e tyre.
- Udhëzimi nr. 4 datë 20.11.2012 “Për mënyrën e vlerësimit të rezultateve individuale në punë të Oficerëve të Seksioneve të Policisë Gjyqësore”. Ky udhëzim synon që nëpërmjet vendosjes së një sistemi vlerësimi të rezultateve individuale në punë të oficerëve të seksioneve të Policisë Gjyqësore, të rritet përgjegjësia në ushtrimin e funksioneve, të promovohet qëndrueshmëria në detyrë, të identifikohen mangësitë profesionale dhe nevojat për trajnimin si dhe të merren masat e duhura disiplinore ndaj atyre që vlerësohen të paaftë.

Prokurori i Përgjithshëm ka nënshkruar memorandumeve dhe marrëveshjeve bashkëpunimi, me drejtues të institucioneve të tjera që kanë rol të rëndësishëm në punën e organit të prokurorisë, të cilat synojnë rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet organeve ligjzbatuese me qëllimin final luftën kundër kriminalitetit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut:

- Memorandum Bashkëpunimi i lidhur midis Prokurorit të Përgjithshëm dhe Organit Kombëtar të Investigimeve të Aksidenteve dhe Incidenteve Ajrore në Aviacionin Civil, nr.3776/1 datë 19.01.2012. Ky memorandum synon të sigurojë bashkëpunimin në investigimin e aksidenteve dhe incidenteve ajrore, që bëhen shkak për fillimin e një hetimi penal nga organi i prokurorisë dhe investigimi nga Organi Kombëtar i Investigimeve të Aksidenteve dhe Incidenteve Ajrore, duke shmangur një konflikt të mundshëm kompetencash, duke ruajtur pavarësinë dhe funksionin e Palëve, për të siguruar që ato të jenë të afta të kryejnë një hetim të saktë; ligj zbatuese
- Memorandum Bashkëpunimi nr. 1406 datë 15.05.2012, i lidhur midis Prokurorit të Përgjithshëm, Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Transportit Rrugor që ka për qëllim rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit, në parandalimin dhe hetimin e trafikimit të mjeteve motorrike, shkëmbimin e informacionit, monitorimin e këtij fenomeni, procedimin e autorëve, nxjerrjen e rekomandimeve për strukturat e varësisë, etj;
- Marrëveshje Bashkëpunimi lidhur midis Prokurorit të Përgjithshëm dhe Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nr. 1434 datë 18.05.2012. Kjo marrëveshje ka për

qëllim të sigurojë përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale të subjekteve gjatë ushtrimit të ndjekjes penale dhe procesit gjyqësor nga ana e prokurorëve;

- Marrëveshje Bashkëpunimi i lidhur midis Prokurorit të Përgjithshëm dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit, nr.1840 datë 28.06.2012 i cili synon rritjen e efikasitetit dhe bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve për forcimin e luftës kundër korrupsionit, duke përcaktuar rregulla për mënyrën e shkëmbimit të informacionit, kontributet e secilës palë për palën tjetër gjatë kryerjes së detyrave respektive, shkëmbimin e eksperiencave etj.

### **FORCIMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM, FORCIMI I KAPACITETEVE**

Kontrolli i brendshëm i prokurorive të rretheve gjyqësore dhe i prokurorive të apeleve, me synim mbikqyrjen e ushtrimit të funksioneve të tyre në zbatimin e Kushtetutës, ligjit dhe akteve normative të Prokurorit të Përgjithshëm, ka qenë një ndër prioritetet e punës së Prokurorisë së Përgjithshme në vitin 2012.

Prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme në përmbushje të këtij funksioni, për vitin 2012 kanë ushtruar kontrole të përgjithshme, të pjesshme, për grup çështjesh dhe për çështje të veçanta. Prokuroria e Përgjithshme për vitin 2012, ka përfunduar kontrollin e përgjithshëm mbi veprimtarinë e punës së Prokurorisë për Krimet e Rënda, Prokurorinë e Apelit Tiranë dhe Prokurorinë e Apelit Durrës, si dhe Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore Pogradec, Korçë dhe Pukë.

Në disa prokurori të tjera, gjatë vitit 2012, janë bërë kontrole të pjesshme, bazuar në informacionet të ardhura nga Drejtoria e Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes Penale, nga Drejtoria Gjyqësore pranë Prokurorisë së Përgjithshme si dhe ankesave të qytetarëve.

Në total, janë kontrolluar 1714 procedime penale, vendime mosfillimi, dosje të gjykuara dhe masa sigurimi në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore dhe në Prokuroritë e Apeleve. Pas kontrollit të kryer për këto procedime penale, është vendosur shfuqizimi për 4 vendime pushimi dhe 2 vendime mosfillimi.

Gjithashtu, është vendosur për të filluar procedimi disiplinor për 6 prokurorë të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit. Në përfundim të procesit disiplinor nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm janë dhënë 4 masa disiplinore “vërejtje”, 1 “vërejtje me paralajmërim” dhe një masë “ulje në detyrë” për 18 muaj.

Në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, nga ana e Drejtuesve të Prokurorisë dhe prokurorët është kontrolluar në mënyrë të vazhdueshme për veprimet e oficerëve të policisë gjyqësore gjatë kryerjes së hetimeve paraprake në procedimet penale. Gjatë dinamikës së kontrollit të hetimeve janë konstatuar zvarritje në hetime, veprimeve që janë kryer në shkelje të Kodit të Procedurës Penale etj.

Në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore, agjensitë e zbatimit të ligjit dhe me organizmat e tjera ndërkombëtar (OPDAT, PAMECA, EURALIUS, etj.) janë intensifikuar trajnimet e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore brënda dhe jashtë vendit.



Kryesisht këto trajnime janë kryer në ato drejtime që kanë ndihmuar prokurorinë që ajo të ketë kapacitetin e duhur për t'u përballur me efektivitet me shkelsit e ligjit si dhe duke nxitur luftën kundër krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe në mënyrë të vecantë pastrimit të parave dhe korrupsionit. Një rol i vecantë i është kushtuar dhe trajnimeve per “Krimin Kibernetik”.

Në kuadrin e vënies në zbatim të Udhëzimit të Përbashkët me Ministrinë e Brëndshme “Për planifikimin, bashkërendimin, organizimin dhe zhvillimin e veprimtarive trajnuese” për vitin 2012 janë kryer 12 trajnime me tema të ndryshme për 60 oficerë të policisë gjyqësore, pranë prokurorive.

Gjithashtu, në bashkëpunim edhe me Shkollën e Magjistraturës është kryer trajnimi vazhdues per disa tema specifike per të gjithë prokurorët në shkallë vendi.

## **MARRËDHËNIET ME MISIONET NDËRKOMBËTARE**

Prokuroria shqiptare është asistuar edhe në vitin 2012 nga projektet e financuara nga partnerët tanë ndërkombëtare, kryesisht nga Komisioni Evropian dhe Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Nga muaji mars 2011, Prokuroria e Përgjithshme ka filluar të zbatojë, projektin e binjakëzimit të financuar nga Komisioni i Bashkimit Evropian me objekt “Mbështetje për strukturat e luftës kundër pastrimit të parave dhe strukturat e hetimit të krimit financiar në Shqipëri”, i cili sipas kontratës AL-2009-IB-JH-03, do të zhvillohet në periudhën 28 shkurt 2011 deri më 27 shkurt 2013. Ky projekt, sipas kontratës, po implementohet nga Instituti Spanjoll i Studimeve Fiskale. Buxheti i këtij projekti i investuar tërësisht nga Bashkimi Evropian është 1.5 milion euro.

Institucionet përfituese nga ky projekt janë Prokuroria e Përgjithshme, Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtorja e Përgjithshme e Parandalimit të Patrimin të Parave dhe Agjensia për Administrimin e Aseteve të Sekuestruara dhe Konfiskuara.

Objektivat e këtij projekti janë: Përmirësimi i koordinimit mes institucioneve përfituese, veçanërisht mes Prokurorisë dhe Policisë së Shtetit; Forcimi i veprimit të Ligjit Antimafia përsa i përket parandalimit dhe konfiskimit të aseteve; Përmirësimi i kapaciteteve teknike dhe veprimeve procedurale që kryejnë entet përfituese në identifikimin, gjetjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve të paligjshme; Adoptimi i masave me qëllim uljen e përdorimit të parasë cash në treg; Përmirësimi i koordinimit ndërkombëtar në identifikimin, gjetjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve të paligjshme; Përmirësimi i koordinimit mes Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorive të shkallës së parë, veçanërisht Njësive të Përbashkëta Hetimore

Në kuadër të projektit janë zhvilluar për vitin 2012 aktivitete të natyrave të ndryshme si seminare trajnuese, tavolina të rumbullakëta, ëorkshop-e, vizita studimore. Janë trajnuar prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore në lidhje me veprën penale të pastrimit të parave, në identifikimin, gjetjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve të paligjshme, teknikat më të mira bashkëkohore evropiane në lidhje me veprën penale të pastrimit të parave, financimin e terrorizmit, krimin e jakave të bardha dhe krimin e organizuar.

Në këto aktivitete është këmbëngulur veçanërisht në kuptimin dhe interpretimin e veprës penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal në përputhje me Konventën e Varshavës, e cila është ratifikuar nga vendi ynë.

Mungesa e një aplikacioni të centralizuar për Prokurorinë Shqiptare që të administrojë të gjithë informacionin e të gjitha Prokurorive të Rretheve Gjyqësore dhe të Apeleve si dhe mungesa e një lidhjeje fizike ndërmjet të gjitha Prokurorive me Prokurorinë e Përgjithshme e bën shumë të vështirë shkëmbimin e informacionit në kohë reale, eficiente dhe të koordinuar për të rritur kështu aktivitetin efektiv të Prokurorisë.

Për të përmbushur këtë mungesë, Prokuroria shqiptare është angazhuar në plotësimin e detyrave të saj për të bërë të mundur përfitimin e projektit të Menaxhimit të Rasteve për Prokurorinë Shqiptare. Ky projekt, në vlerë 3.5 milion Euro financohet nga Komisioni Evropian në kuadër të IPA 2009.

Projekti Menaxhimi i Rasteve parashikon edhe lidhjen fizike të Prokurorëve të rretheve gjyqësore me Prokurorinë e Përgjithshme, duke krijuar kështu një rrjet fizik mbi të cilin do të funksionojë Programi Menaxhimi i Rasteve.

Menaxhimi i Rasteve për Prokurorinë Shqiptare nënkupton program softëare i cili ben kalimin e dosjeve fizike në formatin elektronik. Ky projekt është i ndarë në dy pjesë.

Pjesa e parë është ndërtimi fizik i rrjetit, i cili do shërbejë si platformë për krijimin dhe Instalimin e programit Softëare, çka përbën pjesën e dytë të këtij Projekti.

Faza e parë që përfshin blerjen e pajisjeve të rrjetit dhe të aksesoreve të tjerë elektronikë. Tenderi për finalizimin e pjesës së parë është kryer nga Komisioni Evropian, dhe kontrata me firmën fituese është lidhur në muajin Dhjetor 2012. Aktualisht kompania është në fazën e analizimit të gjendjes aktuale të cdo prokurorie të rretheve gjyqësore dhe apeleve për të vazhduar pastaj me zbatimin e projektit që është instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve elektronike. Nëpërmjet këtij sistemi, të gjitha Prokuroritë e rretheve Gjyqësore dhe prokuroritë e apeleve do të jenë të lidhura me Prokurorinë e Përgjithshme ku do të jetë edhe "Datacenter" për këtë sistem. Ky sistem do të bëjë të mundur që cdo nëpunës prokurorisë do të ketë akses në emailin zyrtar të institucionit si dhe mundësia e shkëmbimit të informacionit ndërmjet prokurorive do të jetë më e shpejtë.

Pjesa e Dytë është Programi (softëare) Menaxhimi i Rasteve i cili është edhe qëllimi kryesor i këtij projekti. Aktualisht, kjo fazë është në proces zhvillimi të tenderit në Komisionin European dhe fituesi nga ky tender. Ky proces digitalizon proceset e punës së prokurorëve, oficerëve të Policisë Gjyqësore dhe nëpunësve të tjerë të administratës së prokurorisë.

Procesi i punës për programimin e softëare-it pritet të fillojë në muajin maj dhe afati i finalizimit të projektit është 20 muaj.

Instalimi dhe konfigurimi i TIMS (Total Information Management System) financuar nga OPDAT

Një projekt tjetër i rëndësishëm për Prokurorinë Shqiptare është edhe implementimi i TIMS (Total Management Information System) i financuar nga OPDAT.

Sistemi TIMS është një sistem e cili bën të mundur kërkimin e të dhënave të automjeteve dhe personave që hyjnë dhe dalin në pikat doganore.

Me ndihmen e OPDAT-it është bërë e mundur ofrimi i këtij sistemi në 12 prokurori të rretheve gjyqësore. Pajisjet elektronike për këtë qëllim janë dhuruar nga OPDAT-i , ndërsa lidhja fizike e Prokurorive të Rretheve Gjyqësore me Drejtorite e Policisë për marrjen e këtij sinjali është bërë nga Prokuroria e Përgjithshme.

Personat e autorizuar për të aksesuar këtë sistem janë prokurorë dhe oficerë të policisë Gjyqësore të Prokurorive që aktualisht janë të lidhura me këtë sistem.

Synimi i Prokurorisë së Përgjithshme është ofrimi i këtij sistemi edhe për prokuroritë që aktualisht nuk e kanë. Për këtë qëllim është bërë e mundur lidhja fizike e prokurorive që nuk e kanë sistemin me drejtoritë e policisë.

Përveç projekteve të përmendura më lartë, Prokuroria e Përgjithshme gjatë vitit të kaluar ka qënë e përfshirë dhe ka përfituar nga asistenca në disa projekte të financuara nga strukturat e Bashkimit Evropian (nëpërmjet misionit EURALIUS), Këshillit të Evropës (nëpërmjet projektit PACA), Qeverisë së SHBA (nëpërmjet OPDAT dhe MCC) e donatorëve të tjerë.

Kjo asistencë kanë patur një impakt shumë pozitiv në punën e prokurorisë, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e efektivitetit të ushtrimit të ndjekjes penale.

### **PRIORITETET E PROKURORISË PËR VITIN 2013**

Duke konsideruar prioritetet e shpallura nga Këshilli i Ministrave për luftën kundër kriminalitetit, në strategjitë kombëtare të miratuara, në progres raportin dhe në rekomandimet që vijnë nga partnerët e huaj për shkak të angazhimeve të shtetit shqiptar në organizmat ndërkombëtare, si dhe në problematikat e punës së organit të prokurorisë dhe tendencat e

kriminalitetit të evidentuara gjatë vitit 2012, prokuroria shqiptare ka përcaktuar prioritete për vitin 2013 si më poshtë:

- ❖ Lufta kundër korrupsionit, krimit ekonomiko-financiar mbetet një ndër prioritete e punës së prokurorisë. Në funksion të këtij prioriteti, me synim rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit ndër-institucional, si dhe për të përmirësuar cilësinë dhe efektivitetin në hetimin dhe ndjekjen penale kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit:
  - do të vazhdojë të mbështetet në të gjitha drejtimet puna e 7-të njësive të përbashkëta të ngritura për këtë qëllim, duke orientuar rritjen e numrit të hetimeve proaktive, rritjen e aftësive hetimore si dhe mbështetjen me staf të trajnuar të klëtyre njësive.
  - Zbatimi me efikasitet i ndryshimeve kushtetuese, në lidhje me kufizimin e imunitetit në nivelet elarta të zyrtarëve publikë dhe gjykatësve, i cili është parë jo vetëm si një pengesë themelore për të hetuar rastet e korrupsionit në Shqipëri, por edhe kontribuon në publikun e gjerë të perceptimi i mosndëshkimit të vazhdueshëm të disa anëtarëve të shoqërisë në këtë fushë.
  - Mungesa e ekspertizës në hetimet financiare dhe e pajisjeve teknike për teknikat speciale hetimore pengojnë efektivitetin e hetimeve në rastet e korrupsionit, do të jetë mnë fokusin e punës së prokurorisë në vitin 2013, me qëllim rritjen e kapaciteteve hetimore dhe përdorimin e teknikave speciale të hetimit. Vlerësim i Bashkimit Evropian ka qenë se “Hetimet proaktive bazuar në përdorimin efektiv të inteligjencës dhe vlerësimin të riskut mungojnë në Shqipëri” edhe në këtë drejtim do të bëjmë maksimumin për të ngritur nivelin e prokurorisë shqiptare në stadartet e kërkuara.
  - Në kuadër të luftës kundër korrupsionit edhe në rradhët e vetë prokurorëve, theksojmë se do të jetë për vitin 2013 pjesë e prioriteteve tona. Në këtë drejtim kemi hapur një adresë elektronike në faqen zyrtare të internetit të Prokurorisë së Përgjithshme një adresë [denonco@pp.gov.al](mailto:denonco@pp.gov.al) nëpërmjet së cilës ftojme të gjithë qytetarët që kanë informacione për abuzime të prokurorëve dhe të zyrtarëve të tjerë në çdo institucion publik, të denoncojnë në këtë adresë postare duke siguruar ruajtjen e konfidencialitetit dhe ndjekjen e shqetesimit të tyre me përparësi dhe korrektesë maksimale.
  
- ❖ Lufta kundër krimit të organizuar, terrorizmit, trafikëve të paligjshme dhe pastrimit të parave do të vazhdojë të jetë prioritet i punës sonë. Për realizimin e këtij prioriteti do të fokusohemi kryesisht:
  - Në forcimin e bashkëpunimit me agjensitë e zbatimit të ligjit brenda vendit, duke i dhënë rrugë kryesisht hetimeve proaktive për goditjen e këtij lloj kriminaliteti. Zbatimin me efikasitetin e duhur të ligjit “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.
  - Zbatimin me efikasitet të ligjit “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”.
  - Shfrytëzimin në maksimum të gjithë materialit informativ që vjen nga agjensitë e ndryshme të shërbimeve inteligjente.

- Në forcimin e bashkëpunimit me agjensitë e huaja të zbatimit të ligjit, duke tentuar të përdorim sa më shumë hetime paralele dhe të rrisim fleksibilitetin në shkëmbimin e informacionit.
  - Në vazhdimin e trajnimeve për të qartësuar kuptimin dhe zbatimin e ndryshime të reja ligjore dhe për përmirësimin e përdorimit më me efektivitet të metodave të posaçme të hetimit.
- ❖ Rritja e efektivitetit të ushtrimit të ndjekjes penale ndaj autorëve të veprave penale të vjedhjes së pasurisë me tendencë në rritje në vitin e kaluar do të jetë prioritet i prokurorisë për sa kohë ajo konsiderohet e lidhur ngushtë me sigurinë publike, duke
- Forcuar bashkëpunimin me strukturat e policisë së shtetit;
  - Ashpërsimin e politikës penale në drejtim të autorëve të këtyre veprave penale.
  - Forcuar kontrollin periodik të procedimeve penale në ndjekje dhe atyre të pezulluara për këto vepra penale.
- ❖ Përmirësimi dhe rritja e vazhdueshme e bashkëpunimit me Policinë Gjyqësore me synim përmirësimin e funksionimit të shërbimeve të policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit dhe me policitë gjyqësore të institucioneve të tjera.
- ❖ Bashkëpunimi ndër-institucional me Ministrinë e Drejtësisë vlerësohet, gjithashtu, aspekt i rëndësishëm që ndikon në rritjen e efektivitetit të punës së organit të prokurorisë. Bazuar në ligjin për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet gjyqësore të huaja, do të synojmë forcimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave përkatëse në dy institucionet. Përmirësimin e marrëdhënieve përsa i përket kontrolleve dhe inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë në sistemin e prokurorisë në funksion të transparencës dhe të pavarësië. Rritjen e bashkëpunimit në grupet e përbashkëta të punës në kuadër të reformës në sistemin e drejtësisë penale.
- ❖ Rritja e kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore mbetet prioritet edhe për vitin në vazhdim. Në këtë kuadër vëmendje do t'i kushtohet:
- Rritjes së transparencës në procesin e inspektimit dhe procedimit disiplinor të prokurorëve.
  - Rritjes së transparencës në emërimin dhe promovimin e prokurorëve.
  - Rritjen e nivelit profesional nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme dhe të specializuara të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.
  - Zbatimit të sistemit të vlerësimit të prokurorëve.
  - Zbatimit të sistemit të vlerësimit të oficerëve të policisë gjyqësore në zbatim të ligjit për policinë gjyqësore.
  - Shfrytëzimit maksimal të gjithë produktit të përfituar nga projektet e huaja në mbështetje të Prokurorisë së Përgjithshme.
  - Përdorimin me efektivitet të fondeve buxhetore për përmirësimin e kushteve dhe ambjenteve të punës për prokurorët.

Megjithë arritjet në vitin 2012, sfida dhe probleme të mëdha kemi përpara. Tendencat në rritje të kriminalitetit të paraqitura në këtë raport do të jenë në fokusin e punës tonë për vitin 2013.

Ju siguroj se Prokuroria në të gjitha hallkat e saj do të realizojë prioritetet në luftë kundër kriminalitetit në përgjithësi dhe krimin të organizuar, korrupsionit në veçanti duke rritur efektivitetin në ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në emër të shtetit si dhe duke garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**ADRIATIK LLALLA**